



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA SEANCA E I E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Seancën e ftoi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, z.Naim Pira. Seanca është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 29.01.2016 (E premte) në ora 10,⁰⁰. Në seancë prezantuan 26 anëtarë të Kuvendit. Në seancë ishin prezent kryetari i Komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, drejtorët e Drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, organizata joqeveritare dhe mediat e shkruara dhe elektronike.

Kryesuesi: Para se të filloj me punë sipas rendit të ditës i përshëndeti të gjithë të pranishmit, si Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, Këshilltarët e Kuvendit, Drejtorët e Drejtorive, Përfaqësuesin e OSBE-së, OJQ-të, Mediat etj. Pas numërimit të këshilltarëve në sallë nga ana e sekretarisë, kryesuesi konstatoi se kemi kuorum dhe mundemi me filluar me punë të seancës së I të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë.

Fillimisht desha të ju uroj punë të mbarë pasi është seanca e parë për këtë vit, dhe unë do të dëshiroja një vit të suksesshëm sikur vitin që lamë pas, gjithashtu dëshiroj të ju informoj se DEMOS-i Zvicerian na ka përkrahur si organizatë në shumë projekte në Komunën e Vitisë, natyrisht ka qenë edhe partner i Kuvendit Komunal dhe ka bërë edhe vjetarin, në të cilin botim janë përfshi punët e qeverisë komunale dhe natyrisht janë përfshi të gjitha vendimet e Kuvendit Komunal, të cilat janë miratuar në vitin e kaluar. Janë të përfshira edhe punëtorit e mbajtura të organizuara nga ana e tyre, unë dëshiroj ti falënderoj para jush për përkrahjen e vazhdueshme të cilën na i kanë dhënë, gjithashtu me kërkesën e z.Bekimit, që ka qenë që të silltet një informatë në lidhje me kanalizimin e Smirës, unë po konsideroj se kryetaret e grupeve parlamentare kanë marrë materialin dhe informatën. Para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës, kisha lut këshilltarët: A ka kush ndonjë pyetje apo ndonjë propozim, fjala është për ju:

znj.Mirlinda Sadiku: Çështjen e parë që do ta kisha ngritur është në lidhje me fshatin Binçë. Në rrugën kalaja e Binçës, drejtori i Shërbimeve Publike ndoshta mund me na dhanë përgjigje, aty qytetaret janë ankuar se nuk funksionon ndriçimi publik. Pyetjen e dytë do ta kisha për drejtorin e Arsimit. z.Drejtor, nuk e di a keni informata, ky është koshi i cili është vendosur në sallën e edukatës fizike dhe nuk i plotëson kushtet, nuk është sipas standardeve dhe paraqet rrezik për nxënësit. Gjatë orës që mbaj shpeshherë sfidohem, këtu është vendosur një syngjer, mirëpo ky nuk parandalon, që mund me ardhur deri te një aksident. Çështja tjetër është, me gjithë respektin e DKRS-së, aty e din se ushtrojnë edhe klubi i basketbollit, kështu që gjitha dëmtimet të cilat bëhen do të na faturohen ne si profesor të edukatës fizike, prandaj unë nuk

mbajë përgjegjësi nëse bëhet ndonjë dëmtim. Do të ishte mirë të intervenohet te kjo, sepse nuk është me standarde, nuk i plotëson kushtet dhe nuk na ka pyetur askush si vendoset, se përndryshe do të kishim dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona. Ndërsa çështja tjetër, kam kërkuar edhe një herë, është kërkesë edhe e sekretarit të shkollës, po ashtu edhe stafit të personelit arsimor, që një vit e gjysmë e kemi fotokopjone prishur, në këtë gjendje është kontrata që na i keni sjell, do të ishte mirë që ta parashihni të na sjellni ndonjë fotokopje të re.

z.Daut Xhemajli: Unë nuk dola për rend dite, por dola për diçka tjetër, shpresoj dhe mendoj se e kam mirëkuptimin e juaj. Gjatë kësaj kohe që nuk kemi mbajtur Kuvend, për kryesuesin është ngritë një akuzë, dhe jam interesuar për këtë çështje, dhe e kam parë që është i akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, apo autoritetit zyrtar, dhe dëmtim të buxhetit të Komunës, për përfitimin për veti ose për të tjerët. Dhe tu interesuar për këtë çështje, kam kuptua se kryetari jon akuzohet, që ne këshilltaret që kemi munguar në seanca dhe janë paguar ato mëditje, do të thotë këshilltaret që kanë munguar me arsye janë lejua dhe kanë marrë mëditje për mos prezencën, këtë dhe si rrjedhojë e kësaj, kryesuesi akuzohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Unë mendoj se pa hy në gjykimin e asaj me çka po merret prokuroria, e di që është një shkelje, po duke pas parasysh se shkelja është shumë e vogël, unë kërkoj që me mirë kuptimin e juaj të bëjmë diçka na si këshilltar, që kjo akuzë të sqarohet së pari për opinion, se opinioni jonë kur merr vesh që është akuzuar për detyrë zyrtare menjëherë perceptimi është që ka bërë keqpërdorim edhe ku me ditë qa paska vjedhë ky njeri, dhe këtë kuptim unë dua me sqarua, se ky Kryesues akuzohet për mëditjet që i keni marr ju, edhe në këtë rast unë tu pas parasysh se ky proces nuk mbyllet tash, kërkoj që gjithë ata këshilltar, që këto mëditje i kanë marrë, po themi të pa ligjshme, të i kthejnë, se unë e di se vullneti i juaj nuk është me dëmtuar buxhetin e komunës. Të prezantohet në gjykatë dhe të kuptohet që edhe këta këshilltar nuk janë të interesuar me dëmtuar buxhetin e Komunës së Vitisë.

znj.Besiana Rexhepi: Pata një pyetje për DKA-në. Duke pasur parasysh që vitin e kaluar janë testuar nxëniet nga instituti "PISA", institut ky që përcakton nivelin e inteligjencës apo koeficientin e ajklusë së nxënësve, do të doja të di se si qëndrojmë ne si komunë në rast se janë publikuar këto të dhëna, dhe në rast se ju mund ta keni ndonjë raport të dhënash rreth kësaj çështje. Meqë sipas mediave thuhet se ky institut në këtë vit ka paraparë ti shpall rezultatet e këtij hulumtimi, pikërisht në janar në rast se nuk jam gabim, dhe se duke ditur se në çdo dokument publik nuk mund të kem qasje, mirë do të ishte të informohet opinioni i gjerë.

z.Sajdi Emini: Unë sot do ta ngriti një çështje, e cila ka pasur të bëjë me stinën e dimrit, kam një pyetje drejtorin e Shërbimeve Publike, që sa ka mund drejtoria me u gjend afër shërbimeve në këto ditë dimri, kur e dimë se ka pasur bukur shumë të reshura. Unë sa di nuk ka mund me i përmbush të gjitha kushtet dhe me qenë d.m.th në shërbim të qytetarëve. E di se disa rrugë, si në Ramjan, Novosellë nuk ka shkuar bageri hiq për me i pastruar, ndoshta arsye është që nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm e që edhe unë po pajtohem, që 50 mijë euro që janë nda për Shërbime Publike nuk mjaftojnë ato edhe për dimër edhe për verë, mirëpo ne si Kuvend, sidomos ju si qeverisje, duhet ta rritni atë buxhet, prej 50 mijë ta bëni 80 mijë euro, që të jetë në shërbim të qytetarëve, përndryshe nëse do të kishte të reshura më të mëdha dhe do të kishte borë ma shumë na nuk mundemi mi bllokuar qytetarët të ju themi se nuk kemi pare, sidomos drejtor i Arsimit, te shkolla, te institucionet patjetër duhet me u pastrua rrugët. Një pyetje tjetër për kryetarin, e kam për fsh Gushicë dhe Germovë. Është një projekt, që është filluar diku para 5 apo 6 viteve, projekti i ujësjellësit, dhe ka ngecur në gjysmë. Ata banor të atyre fshatrave detyrohen të shkojnë të mbushin ujë të pijshëm në

fshatra tjera, si Kabash, Libishtë, Debelde, sepse nuk kanë ujë të mjaftueshëm. Unë besoj dhe do të kishte qenë shumë e rrugës që projektet që janë në gjysmë të përfundohen, mandej të fillojmë me projekte të reja. Kam edhe një pyetje, kemi bërë një kërkesë të mëhershme për ndarjen e një lokacioni (vend) për zjarrfikës, nuk e di ende sa është punuar dhe deri ku ka arritur, kisha pas dëshirë që të na jepni një përgjigje.

znj.Vjollca Kadolli –Halili: Dalja ime ka të bëjë këtu me çështjen që e paraqiti z.Dauti, ku në mesin e personave ose këshilltarëve të cilët kanë qenë të përmendur aty, që kemi marrë mëditje jam edhe unë. Unë menjëherë sa kam dëgjuar rreth kësaj akuze për kryesuesin e kam thirrë dhe i kam thanë se menjëherë jam e gatshme ti kthej ato para, këtë qëndrim e mbaj edhe sot dhe kisha bërë thirrje gjithë atyre këshilltarëve, që jam i sigurt që asnjëri sikur ta kishim ditë që është kështu çështja nuk kishin pranuar as marrje të mëditjes. Kisha lutur që të organizohemi dhe të bëjmë kthimit e atyre mëditjeve, që e quajti me një far mënyre edhe të pa ligjshme.

znj.Mirlinda Sadiku. Shumë zhurmë u bë, sinqerisht po keqpërdoren shumë pare, treguan edhe raportet e fundit në nivel të vendit fatkeqësisht. Në mesin e personave që kanë munguar dhe kanë marr mëditje jam edhe unë, megjithatë unë i referohem nenit 39 të ligjit bazik të pushtetit lokal, pika 8, ku anëtarët e Kuvendit të Komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur nga komisionet, ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsyet të justifikueshme për mungesën e tyre. Unë kam pasur intervenim kirurgjik, qka ka arsye ma të justifikueshme se kjo, megjithatë nuk kam qef mu me drejtuar gishtin si komunë, se edhe pse jemi pjesë e opozitës jemi pjesë e kësaj komune, jemi pjesë e këtij kuvendi, dhe mos të njolloset me këto gjëra. Nuk dua me gjykuar aktvendim si do të jetë, megjithatë unë shprehi gatishmëri, ani se sipas ligjit e kam të justifikueshme ta kthej mëditjen, nuk prish punë.

z.Bekim Azizi: Ju falënderoj për një informatë që ma keni sjell për kanalizimin e Smirës, mirëpo, unë i kam dy pjesë, kam edhe pjesën që ka mbarvijahtur procesi i punës, është problem me shqyrtuar, por në seancat tjera do të flas për të, megjithatë kam kërkuar edhe një listë të subvencioneve për vitin 2014, prapë vazhdoj ta kërkoj, besoj se edhe ato në seancën tjetër do të mi bini, mirëpo, një pyetje e kisha pasur, pasi kemi sot mundësi me debatuar te pika të ndryshme, kisha ba një pyetje. Mirëmbajtja e rrugëve, që është për sezonin dimëror: A është edhe mirëmbajtja e treturave?, sepse e shohë një diqka që nuk është e mirë, sepse mirëmbajtja bëhet vetëm e rrugëve, dhe gjithë ajo borë e rrugëve hedhet në tretuar dhe trotuaret bllokohen, që është një problem i madh.

z.Sejdi Emini: Edhe unë do të lidhem me mendimin e z.Dautit dhe të Vjollcës, kemi pasur edhe ne dy këshilltar të grupit tonë, që e kanë marrë mëditjen pa prezantuar në seancë, të gjithë ne këtu e dimë se kjo është e hapur dhe qëllimi ka qenë, se me arsyet që i kanë dhënë të ju jepet mëditja, siq ndodh edhe me punëtorët arsimor, edhe te shëndetësia, edhe te të gjitha institucionet, mirëpo megjithatë ata e kanë konstatuar se kjo është shkelje, mirëpo, ajo qka mundemi me bë na, na mundemi me dhënë një përkrahje morale, unë jam i mendimit jo vetëm asamblistëve që ju kanë dhënë mëditjet, por nëse dënohet kryesuesi me një shumë ma të madhe të gjithë ne ta lëmë nga një mëditje dhe ta arsyetojmë atë, ta kompensojmë se është gjendje reale faktike, nuk është bërë këtu politik po ka rrjedh qysh ka rrjedh.

z.Samet Idrizi: Siq e dimë ne, CDI-ja një organizatë donacione Zviceriane, që tash është bashkuar me DOSH-in, ka bërë investime të mëdha në Kosovë, po ashtu edhe në Viti, dhe ajo ka një memorandum mirëkuptimi me Komunën e Vitisë për investime të përbashkëta në infrastrukturë, konkretisht në investime kapitale, që lidhen ma shumë me rrjet të ujësjellësit. Pyetja ime është për drejtorin Financiar apo edhe kryetarin e Komunës, se si qëndron çështja

e pagesave për pjesën e vet nga ana e Komunës, pasi që shumë investime, tani në të ardhmen varen kryesisht prej pagesës ose gatishmërisë së Komunës, për me i shlye këto borxhe në mënyrë që të vazhdohet me investime të tjera në rrjetin e ujësjellësit.

z.Bislim Bislimaj: Edhe unë i mbështes koleget, që paraprakisht e ceken problemin e mëditjeve që kemi marrë në këtë mënyrë, dhe kisha thanë se këto ne si Kuvend Komunal kemi drejtë me bë një rregullore ose një ligj me të cilin na mundemi me i përcaktuar mëditjet, se mëditjet janë tonat nuk janë të atyre që bëjnë akuza, d.m.th, ato pare janë të Komunës nuk janë të tjerëve, po nëse domi me ndjek e kemi shumë kollaj, kemi keqpërdorime të shumta që kemi me ndjek dhe me gjet shkelje të rënda e kjo e fundit, me këtë vjetarin që e sjellën sot, me të vërtetë është turp, unë e qela vetëm një herë krejt fletat me mbeten në dorë, sa pare janë dhënë për këtë vjetar aq ma tepër kur janë përfshi edhe DEMOS-i edhe kjo shoqëria zvicerane në këtë projekt, a nuk është turp, p.sh.: për ne nesër para DEMOS-it me dal mi thanë qe vjetari dhe me të mbet fletat në dorë.

Kryesuesi: Meqenëse u diskutua rreth aktakuzës që është ngritë për kryesuesin e Kuvendit Komunal, unë jam informuar nga mediat që më është ngritë një aktakuzë, për faktin se në mungesë të tyre me arsye kanë marrë mëditjet. Unë sinqerisht po them para juve dhe e kam than edhe para mediave, se nëse del se një cent është keqpërdorur nga kryesuesi i Kuvendit Komunal për qëllime të veta, unë jam i gatshëm të përgjigjem para drejtësisë dhe jam i gatshëm edhe tërheqje të jap nëse është nevoja. Faleminderit të gjithëve edhe një herë për përkrahjen të cilën ma dhatë dhe solidarizimit që bëtë për mua, fjalën tash ja jap kryetarit.

z.Sokol Haliti: Para se me filluar me përgjigje, i kisha thënë vetëm 2-3 fjali, në cilësinë e kryetarit të Komunës, për këtë çështje që është ngritë dhe me përmirësua Sejden, që nuk është shkelje, se nuk është konstatuar ende nga gjyqi, është ngrit procedurë për dyshime për shkelje dhe ne besojmë në drejtësinë, është gjë e imët që kemi parë, por dikush e ka ngritur një dyshim, mua më erdhi mirë si Kuvend Komunal, jeni gjithë korrekt, kjo e tregon unitetin veprues tonin, por natyrisht edhe pranimin e dobësive nëse i kemi, por edhe nëse kemi dobësi nuk janë dobësitë e kryesuesit po ka mangësi edhe të dikastereve që duhet me e shikuar një nga një. Edhe Bislimi e ngriti këtë çështje, ndërsa para tij ishte Sameti rreth marrëveshjeve me projektet zvicerane, nuk po e ceki cila, se krejt kemi bë ka pak gabime, kuptimin edhe ma herët që i kemi thanë marrëveshje. Marrëveshjet janë me donatorin, ndërsa CDI-ja është kompani implementuese, e cila faktikisht merr pjesë tash në mes është edhe “Hidro Morava” me projektet e ujit dhe jemi katër palë, mund të them është donatori dhe tri palët implementuese, pra, ne jemi përfitues si Komunë dhe është mirë se është bërë kështu, se kompania regjionale profesionale është “Hidro Morava” dhe besojmë shumë që shumë ma mirë kanë me shkuar punët e implementimit dhe kjo është në tri faza. Është çështja e rehabilitimit të ujësjellësve që kanë mbetur në gjysmë, është pjesa e fazës së katërt që i përfshin këto 6 fshatra, në fazën e katërt ka qenë edhe Gushica, në Germovë është kryer rrjeti, kjo ka ngec për shkak të borxhit të vitit 2011, kemi pas borxhe edhe të vitit 2010 dhe 2009, p.sh.: borxhin e Pozheranit ju kam tregua, të cilin e kemi paguar dhe nuk ka qenë letë për një qeveri të re pa planifikuar me pagua borxhe, mirëpo me ju tregu të drejtë, unë jam duke tentuar me shpëtuar komunën nga ky borxh i vitit 2011 dhe 2010 për 6 fshatra, e kemi fjalën që kanë mbetur vetëm pa u funksionalizuar uji, atë janë tu mundua me bartur te Ministria e Financave, sepse ajo ministri me donator zviceran është bashkëparticipues i mjeteve, diku mbi 8 milion Ministria e Financave participon, prandaj niveli qendror dhe niveli lokal, unë kam menduar si kryetar komune, që besoj që pajtoni, në këtë kuptim me bashkëpunua në mënyrë që ata ne me na liruar prej borxheve të vjetra dhe ne mi implementuar këto projekte, të cilat pa meritën tonë janë ndal, dhe viti 2016 do të jetë funksional sa i përket këtyre, mirëpo edhe

një po ta them, nuk ka qenë vetëm kjo, kanë qenë edhe aspektet tjera të cilat i dinë ata, prandaj unë po them se ka mu funksionalizuar te tri fazat dhe faza e pestë, faza pestë është nënshkrimi i asaj marrëveshje 761 mijë euro plus 300 mijë ne që i kemi zotuar, që duhet me qenë mbi 1 milion, që është Verbani, Smira, Stublla dhe gypi i ujësjellësit të ri, me hek gypin e asbesit prej Letnicës deri në Viti, që është makro projekt për ne faza e pestë, unë mendoj se në këtë kuptim a këtu tash duhet me shikua për Gushicen a e shtinë me krye me Germovë a e shtim në fazën e pestë. Kjo është çështje e modulit që do ta diskutojmë tash, jemi duke i përgatitur me austriakët, që së shpejti do të bisedojmë, është për rritjen e kapacitetit dhe funksionalizimin e ujit për tërë komunën. Ne do ta diskutojmë në Kuvend këtë, se është makroprojekt dhe është 12 milion e 900 mijë euro, do të thotë është për 20 vite dhe pa kamat kthese, do të jetë një makroprojekt, i cili do ta trajtoj ujin e pijes tërësisht për gjithë territorin, ujërat e zeza, tërësisht për gjithë territorin ujërat sipërfaqësore dhe do të ketë komponentë të tjera. Bekimi për kanalizimin e Smirës, na jemi konpatibil në shumicën e sendeve që i kemi diskutuar dhe nuk jam unë për me lëshua pe fare bile edhe rekomandimet e auditorit të brendshëm, unë jam për mi zbatuar në plotësi, pra, në këtë kuptim nuk ka lëshime për ata nuk është pranuar teknikisht. Te lista e subvencioneve, përnjëmend janë transparente, na ja kemi dërgua Ministrisë së Pushtetit Lokal, e di që i keni edhe ju, por është një problem tjetër, unë vetëm nuk kam dashtë të kthehem mbrapa dhe po të them se do ti kesh Bekim, se po shohë se po insiston. Nga Sejda u ngritën disa tema për zjarrfikës, po ka bë mirë Kuvendi që ka nda lokacionin dhe ka bë mirë ministria që ka nda buxhetin për objektin e zjarrfikësve, do të thotë është risi, që objekti i zjarrfikësve do të ndërtohet, është ndarë buxheti dhe kjo është e mirëseardhur, do të thotë se në këtë kuptim të mbrojtjes së kontrollit, si kemi thënë, po natyrisht se lokacionin e kemi ndarë, është mbrapa stacionit. Projekti i ujit, besoj se u përgjigja, se u ndërlidh me pyetjen paraprake. I mbeta borxh Bislimit te vjetari, po të tregoj se vjetari është bërë për promovimin atë ditë, përndryshe vjetari është në shtypshkronjë, ai është origjinal, kjo vetëm ka qenë prova për promovimin e projektit, DEMOS-it. Besiana ka pyetur për nivele profesionale, që drejtori i Arsimit sigurisht për testin e inteligjencës, që na intereson të gjithëve kualiteti në arsim, na intereson të gjithëve. Te informata, do të kini shumë aspekte që ne po mundohemi mi ndihmuar nxënësve dhe studentëve në këtë kuptim. Dauti ka ngritur një çështje parimore bashkë me ju të gjithëve. Mirlinda ka ngritur çështje të koshit, na duhet me biseduar për imsimat ma të vogla edhe për kosh, se është bërë palestra me standarde evropiane, a një kosh na e ndreqim, por ajo shkollë ka drejtor, ka menaxhment për ata e kemi zgjedhur me konkurs, prandaj është mirë orientimi për disa aspekte me drejtuar në shkollë. Kalaja e Binçës, ndriçimi publik, dhe çështjet që i ngriti Sejdiu si dhe tre këshilltar bashkë që e ngritët mirëmbajtjen e rrugëve, unë ju kisha thanë me qenë ju të sigurt, së pari mi vizituar këto rrugë me pa situatën, pastaj me diskutuar në Kuvend, sepse po ju garantoj se rrugët e Vitisë ma të mirëmbajtura ma së miri kanë qenë në Kosovë. Te ndriçimi publik, ne kemi me punuar ende, po rritja e hapësirave në ndriçim është e madhe dhe mirëmbajtja e tyre është shumë funksionale, unë kam si ankesë se po dëmtohen poqët nga nxënësit, nga kalimtarët, gjë që po më pengon shumë, e kam parë edhe në Pozheran, në park, as nuk e kam diskutuar, se më ka ardhur shumë rënd me dëmtua ne atë që po e ndërtojmë.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar, po konsideroj se je përgjigj në shumicën e pyetjeve të parashtruara nga ana e këshilltare komunal.

znj.Mirlinda Sadiku: Kryetar, para se gjithash ajo nuk është palestër sportive, është sall e edukatës fizike, se palestra është krejt diçka tjetër. Nëse tu dok shumë minimale që e ngrita si shqetësim në Kuvend, mua më ka dok e arsyeshme, për arsye se unë jap mësim klasave prej 10/1 deri 10/10, gjithsej kam në mbikëqyrje 272 nxënës, nëse ndodh një frakturë, është

përgjegjësi e imja, unë kam me dhënë raport. Personi i cili ka ardhur me i vendos ato kosha, nuk ka pasur dijeni drejtori absolut për këtë punë, unë e kam informuar dhe e kam sjell në sallë edhe e kam pyetur atë, se donacioni i kujt është, më ka thanë se është prej KARITAS-it. Nuk jam për mos me investuar, mirëpo puna që të kryhet bile le të kryhet mirë deri në fund. Sa i përket rrugës kalaja e Binçës, rastësisht jam ndal një ditë, kam shkuar në vizitë te kunata aty, vetë qytetaret i kam pyetur dhe ata vet më kanë tregua.

Kryesuesi: Atëherë për seancën e parë të rregullt të KK-së të Vitisë kemi paraparë këtë:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e KK-së së Vitisë.**
- 2. Informatë – Raporti i kryetarit të komunës dhe drejtorive komunale për vitin 2015.**
- 3. Draft Strategjia për komunikim dhe informim 2016 -2018.**
- 4. Propozim vendim për hapjen e shqyrtimit publik për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm të Komunës së Vitisë.**
- 5. Raporti i punës i KKS-së për vitin 2015.**
- 6. Draft plani i punës për vitin 2016 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**
- 7. Propozim vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së seancave të Kuvendit Komunal të Vitisë.**

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm, nëse nuk ka e hedhim në votim që të shkoj për miratim: Kush është që të miratohet ky rend i ditës? Konstatohet se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Si pikë **të parë** të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e KK-së së Vitisë

Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?, pasi nuk ka e hedhim në votim që të shkoj për miratim. Konstatohet se me vota unanime miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Informatë – Raporti i kryetarit të komunës dhe drejtorive komunale për v. 2015

z.Sokol Haliti: I nderuari Kryesues i Kuvendit, të nderuar këshilltarë të Kuvendit Komunal, të nderuar drejtorë të qeverisë komunale, të nderuar qytetarë të Komunës së Vitisë, të nderuar përfaqësues të mediave, shoqërisë civile dhe organizatave që veprojnë në komunën tonë!

Kam kënaqësinë që me Ju të diskutojmë për punën tonë gjatë vitit 2015. Sot jam këtu, që më kënaqësinë më të madhe të ju informoj për të arriturat tona gjatë vitit 2015, të dëgjoni për sfidat me të cilat jemi përballur gjatë këtij viti si dhe për planet tona për vitin 2016.

Ju para vetit keni raportet detale të çdo drejtorie veç e veç, sidoqoftë, më lejoni që shkurtimisht të bëj një përmbledhje të punës sonë 1 vjeçare, sfidat me të cilat jemi përballur dhe planet që na presin.

Para se të lëshohem në pjesën tjetër të këtij ekspozitë të shkurtër, më lejoni që me sinjoretin më të madh institucional dhe qytetarë të ju falënderoj juve, përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve, për mbështetjen dhe kontributin tuaj gjatë punës sonë të përbashkët në vitin 2015.

Një qeverisje e suksesshme është e pamundur pa bashkëpunimin e ngushtë me qytetarët, atyre për të cilët jemi këtu. Parim i punës së vazhdueshme është qeverisja me qytetarët, për

qytetarët dhe nga qytetarët, që përbën edhe thelbin e një qeverisje të mirë demokratike, transparente dhe llogaridhënëse. Më gëzon fakti që çdo vendim dhe punë e jona deri më tani ka marr legjitimitetin dhe konfirmimin nga qytetarët. Mbetemi të angazhuar që ky bashkëpunim me qytetarë të rritet edhe më tepër, në mënyrë që puna jonë të jetë direkt e lidhur me interesat e qytetarëve dhe çdo qytetar të përfitoj nga puna dhe angazhimi jonë. Puna jonë në vitin 2015 do të ishte e mangët pa kontributin dhe ndihmën e donatorëve dhe organizatave të huaja, si: Komisioni Evropian, OSBE, Fondacionin Kosova - Luksemburg, DEMOS, etj, si përmes investimeve në projektet e ndryshme ashtu edhe përmes ngritjes së kapaciteteve tona.

Në rritjen e transparencës së punës së qeverisë komunale dhe në ngritjen e brengave dhe nevojave të qytetarëve, është i pakontestuar roli i mediave aktive në komunën tonë, gazetarëve të mediave të ndryshme qendrore, mediave lokale elektronike (radiove, TV-ve, portaleve, etj), faleminderit për punën dhe kontributin tuaj. Unë dhe qeveria ime vazhdojmë të jemi në shërbimin tuaj, që puna jonë të mbërrij tek çdo qytetarë.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal!

Qeveria komunale edhe këtë vit ishte e përkushtuar, që të ofroj një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e komunës sonë: të ofroj shërbime më cilësore publike, të rris kualitetin e arsimit, të ofroj shërbime më të mira mjekësore, të ndikoj në rritjen e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve tanë përmes investimeve direkt në bujqësi dhe përmes krijimit të një ambienti më të mirë për zhvillim ekonomik, të krijoj një ambient më të pastër për jetesë përmes mirëmbajtjes dhe rritjes së hapësirave të gjelbërta në gjithë territorin e Komunës. E gjithë kjo punë dhe angazhim është bërë përmes një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarët, grupet e interesit dhe kategoritë e ndryshme.

Gjatë këtij viti është bërë punë e konsiderueshme në të gjithë sektorët, me një qëllim të vetëm, që të jemi në shërbim të qytetarëve dhe të përmirësohet kualiteti i jetës së qytetarëve të Komunës së Vitisë. Me lejoni të përsëris zotimin tim të dhënë gjatë zgjedhjeve të fundit, që qeveria e udhëhequr nga unë do të jetë në shërbim të qytetarëve, do të qeverisë me qytetarët, për qytetarët dhe nga qytetarët.

Me qëllim që të arrihet kjo, parimet udhëheqëse të qeverisë komunale kanë qenë, janë dhe do të jenë:

1. Zbatimi i panegociushem dhe i përpiktë i kornizës ligjore, që rregullon punën e qeverisë komunale;
2. Transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve;
3. Gjithëpërfshirja e parezervë e qytetarëve, këshillave të fshatrave, organizatave dhe grupeve të interesit në çdo hallkë të vendimmarrjes;
4. Shpenzimi racional dhe efikas i buxhetit komunal dhe parasë publike;
5. Zotimi, disiplina dhe përgjegjësia e çdo shërbyesi të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarë;
6. Kapitalizmi i potencialit të burimeve njerëzore të komunës sonë, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të hapur me organizatat e te rinjve, grave, personave me nevoja të veçanta, bujqve, artistëve, sportistëve, studentëve, etj;
7. Bashkëpunim i ngushtë dhe partneriteti me donatorët dhe organizatat e huaja me qëllim të absorbimit të projekte dhe investimeve në komunë;
8. Bashkëpunimi parimor me qeverinë qendrore dhe agjensionet dhe mekanizmat në nivel qendror.

Puna ime si kryetar dhe e qeverisë komunale gjatë këtij viti është fokusuar në prioritetet si vijon:

- Zhvillimi i bujqësisë;
- Shëndetësia, arsimi, kultura dhe sporti;
- Infrastruktura lokale;
- Shërbimet publike;
- Zhvillimi ekonomik;
- Përkujdesja për shtresat e varfër dhe grupet e marginalizuara;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët;
- Mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës.

Sidoqoftë, më lejoni që shkurtimisht të përmend disa të arritura kryesore në fushat që i përmenda më lartë:

BUJQËSIA:

- projekti i komasacionit;
- shpërndarja e 180 subvencioneve për mjedër, makina spërkatëse, makina mjelëse, krunde, koncentrat, etj;
- dy (2) panaire, njëri në bashkëpunim me RDA;
- mbështetur 3 shoqata të grave me mjete financiare për hapjen e bizneseve;
- hapja e 7 rrugëve bujqësore në gjatësi prej 19 kilometrave;
- shpërnda 12 serra, 42 koshere, 25 krerë dhi.

ARSIMI:

- përrurimi i 3 shkollave fillore dhe 1 shkollë e mesme;
- revitalizimi i 15 shkollave;
- instalimi i kamerave të sigurisë në 13 shkolla;
- rregullimi i infrastrukturës nëpër shkolla;
- kalueshmëria e testit, 2014=65%, 2015=75%;
- fusha sportive nëpër shkolla;
- 71 bursa për nxënës;
- 135 bursa për studentë;
- hapja e 15 puseve të ujit nëpër shkolla;
- sukseset e nxënësve nëpër gara të ndryshme.

FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK

- realizimi mbi 97 % i buxhetit vjetor;
- përfundimi i të gjitha projekteve kapitale brenda afatit;
- hapja e Zyrës për Investime dhe Mbështetje të Bizneseve;
- aplikimi te donatorët e huaj për grande;
- fillimi i themelimit të zonës ekonomike;
- organizimi i trajnimeve për biznese;
- mbështetja e bizneseve vendore.

KULTURË, RINI DHE SPORT

- implementimi i infrastrukturës ligjore;
- hapja e galerisë së arteve, qendrës rinore, kinemaja 3D;
- përmirësimi i infrastrukturës dhe fondit të bibliotekave;
- subvencionimi i 14 organizatave të komunës;
- themelimi i klubeve të reja sportive, shoqatave kulturore;
- suksese në pjesëmarrje në garat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- organizimi i ngjarjeve dhe garave sportive;
- pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje.

URBANIZEM DHE MBROJTJE TE AMBIENTIT

- lirim i hapësirave publike;
- dhënia e lejeve të ndërtimit brenda afatit ligjor;
- hartimi i planit për mobilitet;
- ruajtja e tokës bujqësore;
- regjistrimi i 3,132 objekteve pa leje;
- organizimi i ngjarjeve të shënuara (dita e tokës, dita e ambientit, etj).

SHERBIMET PUBLIKE

- punësimi i 20 punëtorëve sezonal në pastrimin e hapësirave publike në krejt territorin e Komunës;
- rregullimi i ndriçimit publik në qytet dhe fshatra;
- pastrimi i lumit “Morava” dhe Letnicë;
- cilësia e menaxhimit të mbeturinave;
- rritja e hapësirave të gjelbërta;
- menaxhimi i mbeturinave nëpër fshatra;
- mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve;
- evitimi i vërshimeve.

SHENDETESIA

- ndërtimi i QKMF së re në Pozheran;
- përrurimi i emergjencës në Viti;
- funksionalizimi i ambulancave nëpër fshatra;
- rregullimi i hapësirave tek objektet shëndetësore;
- furnizimi i QKMF me aparaturë mjekësore;
- përfitimi i autoambulancës në bashkëpunim me Rotary Club në Viti.

KADASTER, PRONE DHE GJEODEZI

- shqyrtimi brenda afatit ligjor të mbi 11,000 kërkesa për shërbime;
- avancimi dhe modernizimi i shërbimeve kadastrale;
- tërheqja e investimeve dhe grandeve nga donatorët e huaj;
- të gjitha propozimet në Kuvend Komunal në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

INSPEKSIONI

- lirim hapësirave publike;
- analizat e ujit të pijshëm në të gjitha shkollat, cerdhe, cdo 3 muaj;
- pranimit teknik i 50 bizneseve të reja;
- inspektimi dhe ndërprerja e ndërtimeve pa leje;
- inspektimi i kafshëve për sëmundje ngjitëse;
- inspektimi i bizneseve;
- ndalimi i punës së bizneseve joformale.

ADMINISTRATA

- shërbime kualitative për qytetarë;
- është zvogëluar koha e pritjes për shërbime;
- 38,000 banorë kanë kaluar regjistrin qendror;
- janë lëshuar 46,179 dokumente, ndërsa në vitin 2014 janë lëshuar 45,065.

Projektet e investuara ne Komunën e Vitisë ne vitin 2015 janë:

	Projektet	Vlera
1	Asfaltimi i rrugës në fshatin Budrigë	93,500
2	Asfaltimi i rrugës në fshatin Tërpezë	199,000
3	Asfaltimi i rrugës në fshatin Zhiti	199,000
4	Asfaltimi i rrugëve rurale	386,740
5	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Stubëll - faza e dytë	94,629
6	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Sod.Jerlive-Tërstenik- faza e dytë	153,388
7	Renovimi i shkollës fillore në fshatin Ballancë- faza e dytë	40,000
8	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Ramnisht	40,500
9	Rregullimi i kanalizimeve	82,000
10	Ndërtimi i parkut ne Pozheran	60,000
11	Ndërtimi i parkut dhe ndricimi publik	70,000
12	Rregullimi i rrugëve me zhavor	50,000
13	Ndërtimi i shkollës fillore në Beguncë	286,000
14	Participim në projektet me donatorë	282,446
15	Renovime nëpër shkolla	40,000
16	Ndërtimi i QKMF në Pozheran- faza e dytë	69,787
17	Blerja e veturave	30,000
18	Furnizim me EKG	6,432
	TOTALI	2,183,422

Sfidat

- Shkolla fillore në Pozheran;
- Rregullimi i lumit Morava me proçkat përreth;
- Vendkalimi kufitar me Maqedoninë;

- Reparti i hemodializës;
- Mungesa e pronave komunale për zhvillimin e bizneseve;
- Gypi kryesor i ujit të pijshëm Letnicë- Viti;
- Implementimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban.

Projektet investive te planifikuara për vitin 2016 janë:

	Projektet Kapitale	Vlera
1	Asfaltimi - revitalizimi i rrugës Sllatinë e Ultë - Sllatinë e Epërme	110,000
2	Asfaltimi - revitalizimi i rrugës në Lubishtë	110,000
3	Asfaltimi i rrugëve rurale	300,000
4	Rregullimi i kanalizimeve	120,000
5	Rregullimi i rrugëve me zhavorr	45,000
6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik	50,000
7	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese publike	20,000
8	Rregullimi i fushave sportive	25,000
9	Rregullimi i rrethojave të shkollës	15,000
10	Ndërtimi i shkollës fillore në Beguncë - faza e dytë	136,232
11	Renovime nëpër shkolla	55,000
12	Ndërtimi i shkollës fillore në Pozheran	100,000
13	Ndërtimi i ambulants në Skifteraj	30,000
14	Renovimi i ambulantave	15,705
15	Participimi në projektet me donatorë	380,000
	TOTALI	1,511,937

Kryesuesi: Faleminderit Kryetar për këtë informatë, atëherë hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush?

z.Ali Bajrami: Me që kryetari i përfshini të gjitha të arriturat të vitit 2015, për mos me ju lodh me të gjitha ato shifra që i ceku, vetëm kështu në mënyrë të përgjithësuar po hy, po i përmendi. Gjatë vitit që e lamë pas në komunën tonë është bërë një punë shumë e madhe dhe që është e evidente dhe e prekshme për qytetarin e Komunës së Vitisë. Tu ju falënderuar punës, angazhimit dhe seriozitetit me të cilin ju ka qasur krejt kësaj pune kryetari po edhe drejtoret që kanë qenë krah i djathtë në realizimin e përfundimit të të gjitha këtyre projekteve

dhe obligimeve që i kemi pasur para vetës, është investua në shëndetësi, është investua në arsim, në bujqësi, në infrastrukturë, kur të gjitha këto të përmbliohen, atëherë viti 2015 mund të llogaritet si viti ma i suksesshëm në periudhën e fundit në Komunën e Vitisë. Sa i përket investimeve kapitale, ku shuma e përgjithshme është 2 milion e 183 mijë 422 euro, pasi kem këtu edhe raportet, informatat e drejtorive, kam shikuar, si aktivitet që e kanë kryer të suksesshëm i kam përzgjedh për 10 drejtori nga një aktivitet të suksesshëm. Te Drejtoria e Financave kemi shpenzimin e buxhetit 98.99%; Administratë, kemi lirim nga taksat për komunitetin RAI; DKRS-ja, organizimi i Flakadanit, që është bërë në mënyrë shumë të mirë; Në Gjeodezi, dhënia e pëlqimit për minihidrocentralin, që me funksionalizimin e tij do të kemi edhe gjenerime të reja të vendeve të punës; Urbanizëm, përgatitja e dy rregulloreve, të cilat janë miratuar në këtë Kuvend; Në Arsim, përfundimi dhe renovimi i shumë objekteve shkollore; Shëndetësi, përfundimi i emergjencës në Viti dhe përfundimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Pozheran; Shërbimet Publike, mirëmbajtja e rrugëve dhe angazhimi për futjen në sistem të mbeturinave të numrit sa ma të madh të fshatrave, që të kemi një ambient sa ma të pasur, por e kemi edhe pastrimin e lumit “Morava” dhe “Letnica”, që për fat të mirë këtë vit nuk kemi vërshime; Bujqësia, organizimi i panairit vjeshtor tradicional, që prodhuesit komunal po edhe ata të rajonit mundën me i prezantuar prodhimet e veta; Inspeksioni, evidentimi dhe asgjësimi i 50 krerë gjethëve në koordinim me AVUK-in, që kanë qenë të infektuara me tebece. Krejt këtë me përfunduar, është një vit shumë i suksesshëm, e kisha përfunduar me thënien e vjetër latine “veni, vidi, veciu” (“eja, shiko, shko”), por e kish bërë edhe një ndërhyrje, eja shiko, shiko se në Viti me të vërtetë ka qarta të shihet se është punuar shumë.

z.Ekrem Abazi: Në fillim kisha thanë se çdo person duhet me ditë kush është kryetar, kush është këshilltar i kryetarit, kush është këshilltar komunal, mos i ngatërroni ato se ato nuk janë përgjegjësi të këshilltarit komunal. Po filloj te sektori i financave, sistemimi i të gjithë punëtorëve në sistemin e pagave, po ju pyes: A i keni sistemuar edhe punëtorët me kontrata mbi vepër ose shërbime të veçanta. Te sektori i tatimit në pronë po thoni sukses, realizimi i planit vjetor është 75.01%, kurse për taksa komunale të automjeteve 109,52%, nuk është sukses 75% , se dihet se ka pas qytetarë që borxhin e ma hershem e ka paguar 850 euro, e di unë shumë mirë kush ka pagua, a sa i përket për taksa komunale për kerre, aty sun e keni bërë planifikimin mirë, se ka pas kerre ma shumë dhe janë bë pare ma shumë. Më ra në sy, se buxhetin e keni shfrytëzua shumë mirë, a duhet ta dini që në muajin e 10-të buxheti për 9 mujorin e parë të vitit 2015 ka qenë i shfrytëzuar vetëm 45%, edhe nëse ka ndonjë çmim që mund me dhanë komuna, drejtorit ose kryetarit, duhet me ju dhanë ai çmim, se e keni harxhuar buxhetin 99%. Ju kisha propozuar, se në vitin 2016 buxheti të harxhohet me etapa, pra, në katër etapa i ka viti dhe ashtu të harxhohet. E di se në etapën e fundit harxhohen ma shumë pare për investime kapitale, por jo bash në këtë mënyrë. Më ra në sy te do investime që janë bërë, përshembull rregullimi i parkut te rruga “Prizerenit” 9963 euro, rregullimi parkut 9990,80 cent, kjo asnjë nuk e ka kaluar shumën prej 10 mijë euro, d.m.th, keni vepruar qysh keni dashtë me këto. Sa i përket asfaltimit të rrugës Viti- Mogillë, a u asfaltua rruga vetëm pjesa e Vitisë apo e keni asfaltuar edhe rrugën e Mogillës, se këtu po del 122 mijë 318 euro participim me ministrinë MAPL-së, kurse tjetra po del donatorët 98 mijë, po i bie 220 mijë euro. Sa i përket te Administrata, i treguan disa shifra, po tek e fundit punëtorët e kanë obligim me punuar, janë shumë punëtor të mirë, punojnë drejtori ose këshilltari i kryetarit nuk ka nevojë mu merr me këto punë, se ata janë punëtor vetë, janë të vetëdijshëm se duhet me punuar për qytetaret, por shifrat nuk kanë shumë rëndësi po kanë sjelljet e punëtorëve me qytetar, menaxhimi i mirë i automjeteve të administratës ose harxhimi jo i madh i derivateve

për vetura, këto i ka këshilltari i kryetarit. Se sa i përket punëtorëve, janë punëtor të mirë, se prej se e keni marrë pushtetin ju punëtorët qysh kanë dashtë bëjnë, po shlyqyr Zotit janë vetë të interesuar për me punuar për të mirë të qytetarëve, se sa i përket mbikëqyrjes së tyre, absolut nuk mbikëqyren, po janë të vetëdijshëm vet edhe jam falënderues se ata po punojnë për të mirën e qytetarëve.

z.Sokol Haliti: Sikur të ishte ngritë vetëm një çështje ose një temë, kisha pritë, po u ngritën shumë tema, kisha filluar prej fundi. Nëse e ki fjalën, se diktaturë ma nuk ka, është e vërtetë, është përshkrimi i detyrave për secilin punëtor, janë sektorët, nën sektorët, janë përgjegjësit, është hierarkia e organizuar në administratë, janë ligjet, tutorizëm nuk ka për askënd, për shkak se ajo që kam thanë që mu funksionalizuar secili pozicion, secila pozitë, secili sektor, secila drejtori, është tepër e rëndësishme, për këtë po punojmë dhe duhet me u funksionalizuar, në mënyrë që mos me marrë pare kot, por, secili me arsyetua vetën, në këtë drejtim është duke shkuar përpara. Problemi i një qeveri është me kthye invencionin në punë te punëtorët dhe te qytetarët dhe invencionin në Viti për punë është duke iu kthyer në të gjitha fshatrat dhe në administratë. Te tatimi në pronë, drejtori është këtu, sigurisht do të keni debate edhe ma tutje, ka qenë një problematikë që duhet me biseduar bashkë në krejt Kosovën, për shakë të faljeve të borgjeve të vjetra. Sa i përket te investimet në Mogillë, marrëveshja e projektit është e përbashkët, që me u krye rruga Viti – Mugillë. Është e vërtetë që ne kemi fut edhe rrugë tjera, dhe në të gjitha projektet jemi duke punuar dhe jemi të kujdesshëm që me i rregullua rrugët e tona.

z.Bekim Azizi: Unë po lidhëm më së pari, pasi është raport njëvjeçarë, na jepni hapësirë ma shumë me fol. U tha se kemi arritur ormiset e punësimit që i kanë premtua, nëse e ki fjalën për militantë të partisë, se sa punësime janë bërë në Komunën e Vitisë na e dimi, mirëpo, nëse ke pasur kaq punësime të militantëve të partisë, se sa punësime janë bërë na e dimë, mirëpo, nëse e ke pasur të planifikuar kaq me punësuar është mjerim edhe ajo çka ke mendua me planifikuar, se është shumë pak, se na e dimë sa punësime ka, se punësimi është problem kryesor dhe është problem kombëtar, te na çdo shtëpi ka problem me punësim, mirëpo nëse u kanë ky planifikim kaq me punësuar, unë mendoj se është keq. Një proces të auditimit të jashtëm shumë keq e kemi pasur, shumë poshtë, shumë shkelje, diku 500-600 mijë euro janë shkelje aty, që i ka paraqitur. Na e dimë që është punuar, se u kanë buxheti i planifikuar, janë kanë mbi dy milion investime kapitale, shpenzimi i buxhetit bëhet në fund të vitit, punët kryhen në nëntor-dhjetor, asfaltimi të kryhet dy ditë para vitit të ri, ato asfalte janë qar, shko shikoje rrugën e Shkupit në Smirë që e ke shtruar, është qar asfaltimi i rrugës së Terpezës, 16 vende është meremetuar vetëm pas dy jave që e keni shtruar, nëse është sukses qajo punë që është bërë, ato është kanë mirë mi shtrua ka gushti –shtatori, mos me pritë fundvitin. Për dy vite asnjë metër ujë nuk e ke shti asnjë fshat, nuk ke shtie ujë, janë të planifikuar në vitin 2014 226 mijë euro në Smirë edhe në Verban, janë kanë të planifikuar me filluar, jo që nuk kanë filluar, jo që janë bartur ato mjete tjetërkund, as që është biseduar kurrë për ata ujësjellësit, asnjë fshat ujë nuk ka, asnjë qeshmë nuk e keni ndrequr. Kryetar, është një dështim shumë i madh, problem kryesor në Komunën e Vitisë është uji i pijshëm dhe ujë të pijshëm nuk ke bë askund. Ndërtimet pa leje, e pash 40 vendime për ndërprerjen e punimeve, shumë mirë më erdhi, por qato punime a janë kryer, ti ke bë një vendim, ja ke vendos dikujt shiritin, ti ke ecur ai i ka hekë, 7 kat kanë shkuar, nuk ka leje kryetar, qaty pinë kafe çdo ditë, ti e din që nuk ka leje. Kanalizimet janë kanë dy vjeçare, një vit të ka takuar ty, janë kanë në mandatin tanë, janë bë 3 vjeçare dhe nuk janë krye as në Smirë, as në Terpezë, as nuk janë në rend me u krye, d.m.th, që janë pjesë e dështimeve raportin tënd po e diskutoj, se të Alisë jo se e kanë pasur problem në Gushicë a rrugën ka shkolla a ka shtëpia e Aliës dhe te dy rrugët i keni lanë në

gjysmë, nuk keni mund me i krye. Palestra sportive, momentin që ke ardhur në mandat e ke nënshkruar kontratën se është kanë e përfituar prej qeverisë së kaluar, u nënshkrua kontrata, dy vite po bëhen dhe nuk është hala kërkund me u nisë. Në arsim, e lexova raportin të DKA-së, edhe thotë në konkurs për vitin shkollor 2015-16 pati 254 aplikant për 57 norma, në konkurs janë shpallur 16 norma me të 01.08, tre në teknik, 4 në Verban, dy në Smirë, dy në Stubëll, dy në Sllatinë, një në Kabash, një në “Bafti Haxhiu” dhe në Ramjan një, ma shumë nuk ka pasur, konkursin e kemi publik, e keni në faqe të juve, 16 norma kanë qenë, tash 57 minus 16 i bjen se 41 janë pranuar pa konkurs, ato janë 41 shkelje pranimit të vendeve që i keni qar mësimdhënës me punuar. Tani ma vonë e keni hapur një konkurs 15.09 edhe një me të 10.11 edhe një me të 12.01 në shkollën fillore, një mësimdhënës gjeografi 10 orë, ajo normë qysh erdh tash me ditë a ka vdes najkush a ka dal në pension ndokush a qa u bë, është mirë mi shiku kryetar, se janë disa shkelje, se ma vonë ki me u përball, se është interesant se në vitin e parë të këqyrin, vitin e dytë fillojnë me ti paluar dosjet, ndërsa në vitin 3 dhe 4 vetëm nëpër gjykata merresh, po kqyri këto raste. Ligji thotë as zëvendësim nuk mund me qua pa konkurs, mirëpo këto janë duke u bërë, kontratat pardje na kanë ardhur në shkollë me i nënshkrua, d.m.th, na një gjysmë vjetor kemi punuar pa kontrata. Drejtoret e shkollave krejt të kryesisë së LDK-së. Te mjekësia shkojmë, tash një vit e kam pas përmend doktoreshën Vjollca, mu ka hidhëruar shumë, tash po e përmendi doktoreshën Gjylë, 8 fotografi i ka a nuk dinë doktor tjerë me i krye qato që janë apo nuk e di tërë kohën janë këta. Te emergjenca, beso jam kanë javën e kaluar, 5 ditë rend kamë pasur raste, u dashtë me shkuar, shkoni shikoni dyert e emergjencës që është lëshua këtë vit, nuk mund me hy në dyer te njëra tjetra, ku mjekët thonë mos e prek se na bien dera. Më veti një doktor aty, a mos u kanë tender me i vendos dyert e letrës, rëntgeni, 2 muaj nuk ka punuar, qendrat e mjekësisë familjare nëpër fshatra një herë në javë, mjekët tani than nuk ka pacient, normal se nuk ka pacient se ata nuk e presin mu sëmur vetëm të hënën paradite, edhe qat shofer a e pranuat a jo.

z.Bislim Bislimaj: Edhe një herë, edhe shumë herë po më detyrojnë edhe mos me pas plan me fol atë qa di dhe qa mundem. Po kryetari tha për bujqësinë, gjithmonë na keni kritikuar që qa kemi bë, tha mirë, unë nuk po them që nuk keni bë edhe jeni tu bë, kanë bë edhe tjerët para neve, po na po themi çka jemi tu bë në kualitet të asaj, se sa po kontribuon ajo punë e jonja për me ja lehtësua jetën atyre bujqësve, unë edhe vetë merrem me bujqësi, vet merrem me shumë punë, dhe kur i shohë njerëzit sa vuajnë dhe nëpër çfarë sfida kalojnë, vallai më vjen keq edhe më vjen turp mi thanë vetës se jam shqiptar. Janë tri çështje, tri nevoja të cilat edhe i kemi edhe nuk dimë me i shfrytëzua: 1, nataliteti na i ka dhënë perëndia me u shtua, çka po bëjmë për të na, mu atë e sulmojmë. Bujqësia na i ka dhënë Zoti fushën dhe malin, që nuk e ka kërkush, qa ta merr mendja Mali i Zi me pas këtë fushë, është shpall shtet ekologjik dhe tash me këtë ekologji sat kao pensione 3-4 herë ma të mëdha, se na që i kemi d.m.th, nuk po bëjmë asgjë edhe në bujqësi, pylltari i kemi pyjet, jo vetëm si rajon strategjik, por pyje për vetë ekzistencë, për krijim të vendeve të punës e shumë të tjera. E kemi “Moravën”, e cila është e dyta për bukuri natyrore pas “Mirushës”, sa i kemi shfrytëzuar ato, nuk kemi asnjë rrugë deri aty. Tash po lidhemi edhe me rrugë të bujqësisë, që po e lidhin njëra tjetrën, po themi se i kemi shtruar 19 kilometra, po na po harrojmë se edhe tokat që janë në komasacion ato rrugë që i kanë pasur i kanë livruar dhe nuk janë ma, Mos të ishin subvencionet që ndihmohen nga bujqësia nga lart, se nga komuna nuk kemi ndarë fare subvencione. Edhe e treta, e kemi pasurin taksore dhe nëntokësore, pse ne atëherë na nuk e përdorim fare, nuk kemi asnjë fabrikë në Kosovë, a e kemi betonitin dhuratë prej perëndie, nuk dimë me e shfrytëzua, as nuk e përmendim bile asnjëherë, nuk jemi duke punuar, nuk jemi duke pasur strategji një kombi çka i nevojitet, na kemi punuar kundër saj, i kemi mbyllur fabrikat, i kemi

mbyllur minierat, shëndetësia si një aspekt që ndoshta edhe ma së paku më bie mua me fol, se po bëmi vetëm kritik, por me thanë për nevojat që duhet me i pasur në shëndetësi, pra, nuk i kemi edhe atë aparate që i kemi nuk i kemi në shfrytëzim. Gjinekologjia, është turp i madh mos me lind fëmija në Viti, në spital, ajo është për me bë vetëvrasje, njeriu është mëkat me ju thanë të drejtën dhe është marre për sendet që i kemi dhe nuk i shfrytëzojmë, atëherë them athu kush është ajo forcë që neve na pengon.

Kryesuesi: Kryetari e ka një takim në ora 12 me një nga ambasadat, po ja japim fjalën dhe ne prapë mund të vazhdojmë, se ne i kemi drejtoret e drejtorive këtu.

z.Ekrem Abazi: Apet po e cekim atë më herët, 4 projekte janë nga 9990.80 cent, pse nuk u bë 10 mijë e 1 euro, e dyta çka tha Bekimi, po i merr njerëzit partiak, nuk është fare e vërtetë Bekim, këta i marrin klanet e veta, absolut nuk i marrin njerëzit e vetë që janë përnjëmend në LDK, jo sikur është tash LDK-ja këtë qe e the ti nuk është e vërtetë. Tjetër, kisha lut kryetarin që këtë vit mos me ja përshtat individit qysh ja keni përshtat nëpër shumë fshatra, p.sh.: në shumë vende në Viti nuk ka kanalizime, kanë bë kanalizime nëpër fshatra se kanë pas individ që kanë qenë të fortë, d.m.th, kisha një kërkesë prej kryetarit, që këtë vit, që mos ta kqyrë individin sa është i fortë e me investua në atë vend, po me ju përshtatë lagjes e sidomos në Viti.

z.Sokol Haliti: Ekrem, jo që nuk u përgjigja, por, nëse më ke dëgjuar, thash, disa çështje janë profesionale, është drejtori, këtu njëjtë edhe drejtorin e Arsimit, që e shtroj Bekimi, tash po të përgjigjem, ato që janë nëpër 10 mijë euro, në mënyrë profesionale kanë arsyetim, ligji e lejon. Ti po thua se kjo ndarje është bërë për interes të dikujt, për të përfiturar më letë një projekt, unë tash po të them se parkingu i varrezave dëshmorëve, nëse është fusha sportive te shkolla mesme “Kuvendi i Lezhës”, krejt këto janë argumente, se po them, unë nuk jam ekonomist dhe e di se ligji i ri e ndalon këtë ndarje, po nuk e di kur hynë në fuqi ky ligj, po thua se ka hy me 21 janar, pra, prej kësaj date ndalohej, e këta po folin për vitin 2015. Nuk është e vërtetë se militantet e partisë janë duke u punësuar, kjo nuk është absolut e vërtetë, dhe nëse doni u ju jap iks shembuj dhe nuk është e vërtetë se janë duke u ndihmuar militantet edhe për ndihma në bujqësi, ju them shumë shembuj që kjo nuk është e vërtetë dhe nuk është e vërtetë, se shpërndarja e buxhetit është duke u bërë te klanet dhe prej se jam ardhur unë asnjë diferencim nuk është bërë në punë. Te auditorët, nuk jam për temë tabu të auditimit të 2014, na po bisedojmë për vitin 2014, ndërsa ti po kthehesh një vit mbrapa. Edhe një po ju them, ne e sjellim raportin e auditorit dhe shini shumë ndryshime për të mirë ka pas aty, auditori i brendshëm është këtu, sa përmirësime te auditori i brendshëm i kemi bë edhe vazhdojmë me plan operacional mi bë, se unë e respektoj auditmin edhe të brendshëm edhe të jashtëm, ama me argumente, a për çështjet që janë ngrit të nivelit qendror, unë nuk i pranoj si komunë, por as ju nuk duheni me pranuar. Rruga e “Shkupit” edhe rrugët e tjera ishte pyetje edhe nga Bekimi edhe nga Ekremi, unë jam duke dash me u mbrojtur, se janë çështje procedurash, për mua është e rëndësishme mos me u shkelur rregullat, mos me u shkel procedurat e prokurimit, me shkua procedura në rregull, mu bë implementimi në rregull. Edhe u përmend palestra, unë nuk jam tu e ndalur, se ajo i takon nivelit qendror, nuk jam tu thanë e ka pruar kjo apo ajo. Rruga e Terpezë dhe rruga e Shkupit, unë po ju tregoj se me një rrugë që është shtruar më herët ma aq buxhet ne i kemi shtrua tri rrugë, dhe po ju them se rruga e Terpezëz kurrë ma mirë nuk ka qenë, edhe mundemi me bë krahasimin. Rruga e “Shkupit”, e këqyrim knaqëmirinë e qytetarëve atje. Te emergjenca, po pajtohemi me ty dhe te emergjenca po pajtohemi krejt se ka kushte ma të mira, 200 herë ma mirë se kemi qenë, dhe tash dyert e dobëta, na kemi ankesën që e kanë dorëzua, përshake se ajo e ka për detyrë një vit me rregulluar, e ka pasur edhe për rrugë të Potgorcit po nuk e ka rregullua kurrë, ju e dini si

e keni lanë asfaltin dhe ju e dini si e keni lënë asfaltin e Sokoltë në Vorban, unë këto i kam riparua nuk i kam lënë ashtu. Te uji i pijes, mos të ju hedhet faji kësaj qeverie, përshembull për projektet që i kemi të nënshkuara për borxhet e vitit 2011, ato nuk i pranoj, unë kam me bë përpjekje me i zhblllokuar edhe me vazhdua ujin e pijes, edhe me vazhduar me rregulluar. Te mbikëqyrja, kompanitë mbikëqyrëse janë këtu edhe zyrat e prokurimit transparencë të plotë dhe nuk ka për askënd tolerancë. Harrova diçka esenciale, sikur që ka kundër këtu ka edhe pro, nuk është mirë ata që mendojnë se u bë mirë apo është punuar mirë me i kundërshtuar, se nuk e keni të drejtën, sepse nuk i kontribuojnë këto sjellje demokracisë, bile ka edhe shumë që mënojnë që është punua shumë në Viti.

z.Samet Idrizi: Falënderojmë Kryetarin që i bëri një ekspozë raportit vjetor për vitin 2015. Shumica e raporteve kanë qenë të pa nënshkuara, që nuk është mirë, disa edhe të pa vulosura, realisht raporti duhet me u kanë edhe i protokolluar, kështu që herëve tjera të nënshkruhen dhe të protokollohen. Mua më ra në sy transparenca, llogaridhënia dhe profesionalizimi gjatë ekspozesës që e bëri kryetari i komunës, të cilat krejt këto nënkuptojnë të jetë i përgjegjshëm kryetari dhe drejtori në punë. Mendimi jem është se transparenca nuk ka qenë bash në nivel, nisur nga fakti që Bekimi kërkon listën e subvencioneve momentale, që një vit nuk e sjellë kryetari, këtu le për të dëshiruar për transparencën, që e potencon kryetari. Disiplina në vendin e punës nuk është në nivelin e dëshiruar, unë po them se në ambulancë vetë po edhe qytetaret që janë ankuar, që doktorët që duhet me u kanë në vend të punës e bëjnë punën me dembeli, hanë bukë a po pinë qaj kur nuk e kanë kohën e pauzës dhe pacientet presin nëpër korridore, unë konsideroj se këtu duhet me u shtrua kontrolli, d.m.th, kemi vend për me shtua disiplinën z.Kryetar, unë jam falënderues për këto punë që janë bërë, trotuare, vendosje të gypave, po ashtu rrugë janë shtruar, por vërtetë rrugët janë shtruara shumë t ngushta nga 3.5 metra, këtë nuk mund me quajtur profesionalizëm. Mua dje më rastisi me ra me një rrugë me veturën time, dhe ishte shumë vështirë me kaluar dy vetura, sepse rruga ishte shumë e ngushtë, kërkesa ime është që vitin që jemi të shtrohet rrugët nga 4 metra apo edhe nga 4.5 metra, edhe gypat e ujërave atmosferik janë vendosur të profilit të vogël, çka se në reshjet e fundit kanë ndodhë që nuk kanë mundë me kanalizuar ujin edhe uji u rrit në disa pika ku ka qenë problem gjithmonë. Kështu që, aty duhet të intervenohet, po edhe trotuaret tjerë që duhet të shtrohen në të ardhmen le ti vendosin gypat ma të mëdhenjtë atmosferik, që të përcjellin ujërat. Unë kisha filluar për çdo drejtori nga pak, unë i kam lexuar, disa raporte janë kanë ma profesionale, disa nuk janë kanë mirë të detajuara. Tash e tutje unë bëjë kërkesë, se në të punohet ma pak, po le të bëhet puna mirë. DKA-ja, unë e lexova raportin, ku thotë, kemi bërë furnizime me mjete higjienike sanitare në nivelin e duhur, unë kam parë këtu, ndërsa unë kam ni nga asamblistët se ka mungesë, ka vonesa në furnizim me mjete higjienike, sanitare, kështu që në të ardhmen të jemi ma të përpiktë në këto furnizime, sepse këto janë shumë me rëndësi për pastërtinë nëpër shkolla. Edhe lexova, se nxënësit tanë kanë marr pjesë në një olimpiad matematikore në nivel të Kosovës, po dua me dit ata nxënës që kanë qenë qysh janë profilizua, çfarë vende kanë nuanë, dhe më intereson për kureshtje sa është numri i nxënësve prej klasës së parë deri në klasën 13, totali në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014, sa kemi rënie të nxënësve. Te Drejtorja e Urbanizmit, unë pash se këtu vërtetë është punuar pak në dhënien e lejeve për ndërtim, kam informata prej qytetarëve që janë të interesuar, se zyrtaret të cilët punojnë në këtë drejtori po i kushtëzojnë ndërtuesit, që ata të ju japin punën e hartimit të projektit ekzekutues në këmbim të lejes së nderimit. Unë kam informata se aty ka edhe konflikt interesi, zyrtaret që punojnë aty dorëzojnë projekte me nënshkrim të vetin, që nuk lejohet hiq kjo kështu, se drejtori është mirë të merret me këta persona. Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, unë te

Sektori për Pylltari dhe Zhvillim Rural, na e kemi cek edhe ma herët, sot kemi bërë mbylljen e 10 rrugëve me ekskavator, unë po shpresoj se nuk kemi drejtë rrugët me i mbyll, rrugët duhet me i hap dhe nuk ka nevojë me u mbyll rrugët, po ata pylltar që marrin rroga, duhet me qenë në nivel të detyrës, se marrin paga prej këtij buxheti. Lexova edhe për disa dëme që janë shkaktuar në vërshime, në ferma të deleve, të dhive, të lopëve, sigurisht drejtori për Bujqësi mund me na sqaruar, sa këta qytetar tanë janë ndihmuar për të ju kompensuar dëmet që ju janë shkaktuar. Drejtorja e Financave, Sektori i Buxhetit dhe i Thesarit, unë i lexova se të gjitha deklaratat e disponueshmërisë së mjeteve dhe elementëve tjera kanë qenë në nivelin e duhur, po flas për vitin 2014, se për vitin 2015 nuk i kemi marrë auditimin si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Për vitin 2014 vetëm janar-mars një auditim që e ka bërë KRPP-ja, ka 15 shkelje të Ligjit të Prokurimit, ka 4 -5 vende ku deklaratat e disponueshmërisë së mjeteve nuk është plotësuar fare, ky raport është publik, unë me një seancë të ardhshme do ta sjelli dhe do të ja shpërndaj, dhe ju e shini vet, është raport final, ku shihet se ka shkelje, shpresojmë se vitin 2016 mos të ketë dhe unë po e shohë se Zyra e Prokurimit bie nën Drejtorinë e Financave, e përmendi ma herët Ekremi, përnjëmend ka pasur ndarje të prokurimit, kjo do të dëshmohet, se tash do të bëhet publik raporti tjetër i KRPP-së për vitin 2015, dhe një pyetje për drejtorin e Financave, shkruan se janë punësuar 235 punëtor. Më vjen shumë mirë, pyetja është: Ku janë punësuar ata dhe sa janë të qëndrueshme ato vende të punës? DKRS-ja e ka sjell një raport ma të kompletuar, ka ofruar informata të bollshme, megjithëse edhe ky raport është i pa nënshkruar. Kam një pyetje për drejtoreshën, e di se është bërë një investim i madh në Kinema, nuk e di a ka fillua me shfaqur filma, a pritet me u shfaqur në të ardhmen. Drejtorja e Shëndetësisë, më duket se përfshina ma herët, edhe ky raport është i pa nënshkruar. Unë mendoj se drejtori duhet pak ta rris kontrollin aty, sidomos në ndërrim të natës. Drejtorja për Shërbime Publike, personalisht kam mendim të mirë për këtë drejtor, vazhdimisht është në teren, është në nivel të detyrës, te kjo drejtori kam ankesë se ju hedhet bërlloku para derës së shtëpisë, këto ndodhin ma shumë në fshatra jo në zona të urbanizuara, konkretisht në fshatin Kabash, bile aty ka pasur edhe një rraje mes qytetarëve, se ja ka hedh bërllokun para dere, është mirë këto raste me i identifikuar edhe këta njerëz me i dënuar që hedhin bërllok vend e pa vend. Drejtorja e Administratës, unë mendoj se te kjo drejtori sinqerisht ka nevojë për përforsim të kontrollit të brendshëm të punëtorëve, aty nuk rrinë bash mjaftueshëm në vendet e punës edhe shpesh pinë duhan. Edhe Drejtorja e Inspeksionit, më duket se vazhdon ende me ushtrues detyre, kjo nuk po më pëlqen fare, është viti i tretë, normal se drejtori i Inspeksionit nuk mund të jetë në nivel të detyrës edhe nuk e ka përgjegjësinë e plotë me ushtrua punën e vetë ashtu siç duhet, duke qenë ushtrues i detyrës.

z.Sokol Haliti: Edhe ashtu shumica e pyetjeve janë për drejtorinë veç e veç, na edhe ashtu me propozimin e Kuvendit, drejtorit janë këtu prezentë, shumë pyetje janë ngritë edhe më herët, që unë nuk ju dhashë përgjigje, për shkake me ju lënë hapësirë drejtorëve, nëse nuk keni edhe diçka për mua të veçantë dikush, unë isha nisur për rrugë, kam në Prishtinë takim.

Kryesuesi: Pas pushimi vazhdojmë me punimet e seancës, fjalën e ka z.Dauti.

z.Daut Xhemajli: Unë edhe herëve tjera kam thënë që s'po më pëlqen në një seancë me i shqyrtuar gjitha raportet, sepse nuk po i shqyrtojmë përmbajtësish dhe kështu veç e veç. Te Drejtorja e Ekonomisë, pavarësisht se janë mbi 2 milion investime, mua si këshilltar më pengon kjo puna e mosrealizimit të projektit të sallës së sporteve që 2 vite. Unë konsideroj që kjo zhagjitje është e qëllimshme, aty mund të ketë edhe pazare të atyre që kanë luftuar ta marrin tenderin, megjithatë Komuna e Vitisë është dëmtuar për 1 milionë e gjysmë edhe prapë do ta kemi në projekt, por kishim mundur të kemi projekte të tjera. Mua më gëzon fakti që te Drejtorja e Bujqësisë i kemi 1 milionë e 200 - 300 investime dhe janë përfitues fermerët tanë,

por, mbi të gjitha prej Ministrisë së Bujqësisë janë 1 milionë e 200. Nuk e di ku kanë shkuar, është e vërtetë që flitet që ata që kanë lidhje janë përfitues, por megjithatë mua si vlerë më gëzon dhe është mirë që është bërë. Një konstatim te Drejtoria e Inspektionit, nuk më pëlqen se gjendja mjedisore në komunën tonë nuk është e kënaqshme, sidomos te mbeturinat në lokalitetet ku mungojnë ata vendgrumbullimet, edhe në këtë vit në disa lokalitete edhe pse kanë shpreh gatishmëri me hy në sistem të menaxhimit, kompania nuk ka kapacitete të shërbej. Në këtë aspekt te Drejtoria e Shërbimeve Publike thuhet që kemi sistem të menaxhimit në shumicën e fshatrave, unë e di që në të gjitha këto fshatra që është përmend kemi sistem, por jo në tërësi, problemi është që në fshatin Kabash ose Beguncë nuk është i gjithë fshati i futur në sistem edhe ata që paguajnë 10-20 familje, por tjerët që nuk paguajnë ku janë ato mbeturina, problemi është që ne të përdorim mekanizëm që të gjitha familjet të futen në sistem.

Te Drejtoria e Arsimit, nuk e di sa është e saktë, thotë të gjitha shkollat janë furnizuar me kohë me material higjienike, tjera, kam dëgjuar që nuk ka pasur kohë pas kohe kësi lloj material higjienik, hargjues e për zyre, kam informata jo zyrtare, kërkoj prej drejtorit me e plotësuar, a ka punëtor të arsimit që janë jashtë listave të pagave dhe sa rrezikohet ky sistem, duke e pasur parasysh informatën që kemi për vitin 2015, mos me mundur me inkuadruar këta punëtor. Kisha pasur dëshirë që krahas intervenimit nëpër shkolla, që është renditur, këtu ta kemi një listë të vlerave sa është investuar, se po krijohet përshtypja se në të gjitha është intervenuar. Drejtor, te kamerat është mirë që janë vendosur nëpër shkolla, por kamerat janë për vende publike korridore, jashtë korridoreve etj. Kam informata që në një shkollë kamerat janë të vendosura ka arsimitarët, do të thotë drejtori i mbikëqyr arsimtarët, prandaj nuk është në rregull kjo. Një çështje tjetër, që mendoj nuk është në rregull te Drejtoria e Shëndetësisë thotë, kërkesë UNMIK-ut në Prishtinë për inventar. Kjo më duket absurde, sepse nënkupton që duam me kthyer dhe po kërkojmë ende prej tyre ndihmë edhe nëse duhet kjo komunë është dashur të investoj vet, por me kërkuar dhe me marr inventar prej zyrave të UNMIK-ut, duke e njohur raportin tonë me këtë institucion.

z.Hasan Aliu: Unë nuk do të përgjigjem në asnjë pyetje, se krejt pyetjet janë konkrete, por do ta marr atë barrën nëse ka fajësi. Në mesin e atyre që e ka bërë kërkesën në UNMIK jam unë jo drejtori i Shëndetësisë, sepse është një përkthyes, një shok i joni, dhe në momentin kur ata i kanë reduktuar punët e veta dhe material të cilin e ka konsideruar se do të jenë ndihmesë e Vitisë, me ka thirru në telefon të bëj një kërkesë, sepse pa të nuk mund ta bësh shkarkimin e mallit, prandaj, unë nuk konsideroj se nuk ka diçka të keqe dhe i jam mirënjohës atij.

znj.Kaltrina Sylejmani: z.Samet Idrizi e bëri një pyetje rreth funksionalizimit të kinemasë 3D, kam kënaqësinë të iu informoj se kinemaja do të lansohet në muajin prill, sepse është dashur të realizohet dokumentarin për Vitinë dhe do të lansohet bashkë me të.

z.Ibrahim Rama. Është fjala për z.Ekrem Abazi, që pyeti se çka është menduar kur është thënë sistemimi i të gjithë punëtorëve në sistemin e pagave në të gjitha programet sipas planifikimit të buxhetit 2015. Ky është një sqarim i shkurtër ligjor, do të thotë të gjithë punëtorët në nivel të komunës shëndetësi, arsim dhe administratë komunale janë të radhitur në listën e pagave zyrtare në Ministrinë e Pushtetit Lokal edhe Ministrinë e Financave, gjegjësisht në Sektorin e Thesarit. Do të thotë asnjë punëtor nuk e kem jashtë sistemit të pagave.

Një pyetje tjetër ishte, përqindja e vogël e shpenzimit të investimeve kapitale për periudhën 3 mujore, këtë problem të kësaj përqindje edhe disa herë e keni potencuar, për arsye objektive kanë ndodhur këto përqindje ne 3 mujorsha, kështu që në fund ia kemi arritur

qëllimit dhe buxheti për shpenzime kapitale për vitin 2015 është 97,03 % ose buxheti total i shpenzuar është 99,08%.

Projekti i asfaltimit të rrugës Viti-Mogillë, ky projekt nuk ka qenë në listën kapitale të projekteve për vitin 2015, ndërkohë me angazhimin e kryetarit dhe Drejtorisë për Financa kemi arritur ta përfitojmë një fond nga Ministria dhe kusht ka qenë një projekt që i prek dy komuna dhe kemi ardhur në përfundim, që kjo rrugë i prek dy komuna dhe komuna ka participuar me disa mjete dhe në kuadër të këtij projekti e kemi asfaltuar edhe rrugën e Ramnishtës që del për Letnicë dhe rruga të "Flaka e Janarit".

Një pyetje tjetër për të hyrat e tatimit në pronë, kësaj radhe janë të vogla dhe as ne nuk jemi të kënaqur, përqindja është diku 75% e që ka ndikuar falja e borxheve në këtë drejtim. Pyetja tjetër ishte disproporcioni i investimeve kapitale nëpër lokalitete, që po bëhet në mënyrë politike apo klanore. Unë sa për informim i kam marr 5 lokalitete që i kam paraqitur shpenzimet e investimeve kapitale, sipas fshatrave, duke u nisur nga qyteti i Vitisë, fshati Beguncë, Kabash, Pozheran dhe Smirë. Viti 2014, investimet janë shpërndarë kështu nëpër këto lokalitete, gjegjësisht në qytetin e Vitisë 326 mijë euro, në Beguncë 2128 euro, në Kabash 20015 euro, në Pozheran 326030 euro dhe Smirë 179028 euro dhe në vitin 2015 struktura e shpërndarjes së këtyre investimeve nëpër këto lokalitete është kështu: në Viti 321957 euro, në Beguncë 286737euro, në Kabash 90500 euro, në Pozheran 270000 euro, në Smirë 37340 euro, kjo sa për informacion se nuk ka subjektivizëm.

z.Qahil Sinani: Te çështja e kamerave, janë 12 shkolla që nga fondacioni Kosovë-Luksenburg dhe 2 shkolla i kanë pasur më herët kamerat. Vendosja e kamerave është bërë me pëlqim të punëtorëve, nuk cenon në asnjë vend privatësinë e punëtorëve. Çështja tjetër është se sa janë dhënë mjete për rivatilizim, 72,000 euro janë mërgimtarët, ndërsa 74,000 euro komuna, 40000 euro në Lubishtë, mërgimtarët kanë investuar 6500 në Remnik, 5500 në Smirë, 20000 në Stubëll. Nuk ka punëtorë jashtë sistemit dhe i kemi edhe 12 vende të lira. Një pyetje tjetër ishte, sa nxënës 2013-2014 kanë qenë 11470, ndërsa 2014-2015 janë 10100, ndërsa 272 ishte eksodi që ishte dhjetor 2014.

Mjetet higjienike sanitare s'është e vërtetë që mungojnë, kanë marr mjete higjienike, ndoshta kanë harxhuar, por jo të gjitha. Te konkurset, te na është viti kalendarik shtator-shtator jo janar-janar, pra, shtator 2014 ka pasur konkurs dhe shtator 2015 ka pasur konkurs, këtu llogariten edhe vendet e pushimit të lindjes, zëvendësimet dhe pushimet mjekësore. Në zëvendësim merren pjesëmarrësit e konkursit për vend të përhershëm, gjithmonë hapet konkursi. Çështja e komisionit, PISA është organizatë që mat cilësinë e arsimit, por, këta nuk na raportojnë neve, por Ministrisë së Arsimit.

z.Sejdi Emiri: Pasi u diskutua çështja e arsimit, pasi vet jam punëtor i arsimit, do të dal ti them disa fjale edhe unë. Është shumë e vërtetë që shkollat në komunën tonë ballafaqohen me mungesë të gjërave elementare, është shumë e vërtetë që ka munguar edhe letra A4, ka munguar toneri, fotokopja, testi, detergjentet e pamjaftueshme, ndoshta kanë ardhur me vonesë, por edhe një shtëpi private ishin shpenzuar e le me një shkollë publike. Ka mungesa të rekuizitave sportive, nuk ka as topa. Ka disa shkolla që janë me banjo jofunksionale, sepse iu iken këtyre gjërave, e të flasim për digjitalizim të kamerave, atëherë është një kontrast i madh dhe nuk jemi në realitet. Ajo çka është më shqetësuese, ne po ikim prej politizimit të punëtorëve të arsimit, unë po them që ka politizim të punëtorëve, unë po them që ka raste që merren punëtorët pa konkurs. Ajo çka më ka shqetësuar më së shumti vendet e punës po rezervohen para 6 muajve, me një rast ka shkuar me kërkuar vend pune dhe ka qenë i zënë para 6 muajve. Me një fjali që e the edhe 12 vende janë të lirë, unë po them si thotë populli kuku çka i bane vetes, kanë me ta thy derën.

z.Bekim Azizi: Raporti po thotë me kohë kemi shpallur konkursin publik për kuadër arsimor, për vitin shkollor 2015-2016, aty shkruan që në këtë konkurs pati 254 aplikime për 57 norma dhe e shikova në konkurs, kanë qenë të shpallur 16 vende, 8 janë kërkuar për ciklin klasor, ti menjëherë i ke pranuar 13.

z.Sami Demelezi: Se vërtetë është bërë një punë e mirë tregon edhe shpenzimi i buxhetit mbi 98% dhe konsideroj se kjo shtrirje e këtij shpenzimi të buxhetit ka prekur në të gjitha lëmenjtë e jetës së komunës sonë, duke u nisur nga ambienti, që sot kemi një ambient tjetër edhe brenda qytetit, por edhe lokalitete kemi një ambient shumë më të pasur dhe duke vazhduar edhe me investimet tjera si në rrugë dhe kanalizime. Unë pashë që z.Sameti ishte falënderues, edhe unë pajtohem që këto rrugë me 3 metra e gjysmë janë të ngushta, por, më mirë me i shtruar kështu, sepse kemi nevojë, por, të mbështes se rrugët është më mirë me të qenë me të gjëra në të ardhmen, por mundësitë këto janë.

Thanë që auditimi i jashtëm ka dal keq, edhe unë jam i atij mendimi që ka dal keq, sepse me u akuzuar një kryesues për shpenzimin e buxhetit për 875 euro edhe atëherë kam thënë që edhe Mirlinda ka shkuar në operacion, që ajo më së paku ka dashur të shkoj dhe kryesuesi ka thënë që veç një gjendje reale që me arsye dhe pa arsye, prandaj me u ankuar sot po ndodhka dhe uroj që edhe këtë vit të jemi të suksesshëm siç kemi qenë edhe vitin e kaluar.

z.Basri Aliu: Kjo çështja e emergjencës që e ngriti Bekimi, që dyert e saj nuk janë aq funksionale edhe ne e kemi dhënë një vërejtje që e kemi dërguar në Zyrën e Prokurimit, shpresoj që do rregullohet edhe kjo. Diçka tjetër ishte për fotografitë, unë e di që je inxhinier Bekim, por që ke pasion edhe për fotografi tash po e di, se herën e kaluar e ke potencuar Gjylen, por unë do ti falënderoj këto dy doktorëshat për aktivitetin që po e tregojnë, por edhe tjerëve iu kam ofruar, por po kërkojnë ndihmë financiare me iu dhënë, ndërsa këto po e bëjnë në mënyrë vullnetare.

Sameti, me të drejtë e ngriti çështjen e disiplinës edhe unë jam që disiplina me qenë nivel, besoj që është e duhur, por ka nevojë ende për përmirësim, ndërsa sa i përket çështjes së pauzës, është pak çështje specifike të qendra e mjekësisë familjare, se pauzat bëhen pjesë-pjesë për hir të qytetarëve dhe sa herë shkoj s'besoj që pret dikush më shumë se 1 minutë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, por ka nevojë për përmirësim. Te ambulanca, sigurisht e ke pasur fjalën për Smirë, një herë në javë mjeku, sipas OPSH-së dihet që mjekë në 2500 banorë duhet me pasur, por numri i mjekëve në Komunën e Vitisë është i kufizuar dhe kemi bërë kërkesë në ministri për rritjen e numrit të tyre.

z.Skender Ahmeti. Unë kam pritur që në këtë raport të ketë shumë më shumë pyetje, por që nuk pati, përveç pyetja e Bekimit për ndërtime pa leje, që është një sfidë shumë e madhe jo vetëm për Komunën e Vitisë, por mu duk pak e rëndë që ma përmendi çështjen që po e vendosim vetëm një shirit dhe po vazhdojnë punimet. Nuk kam dëshirë me u lidhur me të kaluarën, por ndonjëherë duhet përdorur edhe periudhën krahasuese në pushtetet e mëparshëm, njerëzit më të lartë të qeverisë kanë ndërtuar objekte e restorante pa pasur kurrfarë leje, as inspekcioni s'kanë shkuar; e dyta, është që krijimi i Komunës së Kllkotit na ka shkaktuar telashe të madhe, që është vështirë me i zgjidhur dhe shumë raste po i dërgojmë në gjykatë.

Sameti e përmendi pirjen e duhanit në Administratë, në këtë vit kam kërkuar që të përgatis disa formular, iu ka ndërprerë kontrata atij që e ka këtë detyrë dhe kam kërkuar nga prokurimi që sa më shpejtë ta zgjidh këtë çështje. Për gjendjen mjedisore në raport Dauti e ka lexuar dhe ka konstatuar se gjendja është e rëndë për shkak të mos menaxhimit nga kompania, ne e kemi fshatin Binçë, Podgorc, kanë kërkuar që të futen në sistem, ndërsa kompania nuk është e gatshme me e realizuar atë, prandaj komuna ka të drejtë të marr në menaxhim këtë.

z.Ajet Sallahu: Dashta të lidhem me atë që tha z.Samet Idrizi, se disa zyrtar të Drejtorisë së Urbanizmit qesin nënshkrime në projektet e tyre dhe i kushtëzojnë të tjerët që të marrin projektet nga ta dhe t'iu jepet leja e ndërtimit. Nënshkrimi që zyrtari e paguan taks jashtë orarit të punës për 4 orë, por nuk është i njëjti zyrtar që e jep lejen e ndërtimit, prandaj nuk kemi konflikt interesi; e dyta është, nuk kushtëzohen, sepse raportin e keni përpara nga 17 kërkesa për leje ndërtimi, vetëm 1 është refuzuar, sepse nuk i ka plotësuar kërkesat ligjore.

z.Samet Idrizi: Kam një pyetje për drejtorin e Urbanizmit: A ka shkelje dhe a ka lëshime sa u përket të gjitha punëve.

z.Ajet Sallahu: Unë sa kam njohuri dhe sa kam mundur me kontrolluar nuk ka shkelje, nëse ke ti diçka, unë jam i hapur me i marr hapat dhe me i ndëshkuar.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi

3. Draft strategjia për komunikim dhe informim 2015-2016

Ftoj nënkryetarin që të marr fjalën për këtë pikë rendi ditës.

z.Hasan Aliu: Ka qenë iniciativë që ta përgatisim një strategji, qëllimi është që informimi, komunikimi, transparenca komunale të jetë më e rritur dhe të krijohet një bazament i një dokumenti mbi gjendjen që është dhe vizioni që synohet të arrihet. Pjesëmarrës të këtij grupi kanë qenë nga politika, dhe shoqëria civile dhe dua ta falënderoj Ibrahim Sefedinin nga shoqëria civile, që një kohë ka qenë edhe koordinator i grupit punues, ky ka qenë një ekip heterogjen. Këtë dokumente i keni para jush, për çdo vërejtje, propozim, sugjerim i mirëpresim dhe jemi të gatshëm ti inkorporojmë në kuadër të kësaj strategjie.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: Donë dikush ta merr fjalën?

z.Sami Demelezi. Sa i përket kësaj strategjie, kam pasur fatin të jem në një trajnim me një grup të komunës sonë dhe në bashkëpunim me OSBE dhe komunat tjera si: Novobërda, Hani Elezit dhe Fushë Kosovë, ku kemi biseduar rreth kësaj strategjie komunale. Të gjitha komunat që ishim atje, kemi bërë një strategji më të avancuar se komunat tjera dhe ato që veç e kanë këtë strategji, siç ishin komunat Podujevë dhe Prizren. Ajo çka na është dhënë si vërejtje për shkak të hapësirës së pjesës së bashkëpunimit me mërgimtarët, që ne e kemi për fat një bashkëpunim shumë të mirë me ta, i kemi kushtuar një rëndësi me të vogël, që edhe unë kam propozuar, fal bashkëpunimit të mirë që kemi me mërgimtarët, që në këtë aspekt të bëjmë një bashkëpunim më të mirë me shtetet që i kemi mike. Një bashkëpunim me komunat e kryeqyteteve, që si urë lidhëse kemi mundur me i shfrytëzuar diasporën tonë. Gjithashtu edhe sa i përket çështje së implementimit të kësaj strategjie, ne kemi qenë të kujdesshëm që të bëjmë një përputhje me buxhetin e komunës, që e kemi ndarë gjatë degjimeve buxhetore, prandaj edhe në implementim konsiderojmë se kjo strategji do të jetë e implementueshme, sepse shumica e buxhetit veç është e ndarë për këtë strategji komunale, dhe duke i pasur parasysh të gjitha këto, unë propozoj që është një strategji që ia vlen ta votojmë. Ne si grup parlamentar i LDK-së jemi për.

z.Sejdi Emini: Kjo strategji për ne është një përmbledhje e obligimeve ligjore të institucioneve komunale publike. Ne jemi në rregull me këto obligime, mirëpo është shumë e rëndësishme se çfarë informata iu ofrojmë dhe sa janë reale ato. Ajo që është brengosje, ne të gjithë në këtë strategji duhet me qenë transparent financat dhe projektet të cilat i financojmë dhe sa kushtojnë. Për ne shpenzimi i parasë publike është treguesi më i mirë i qeverisjes. Konkretisht ne kërkojmë që të bëhen publike në webfaqen komunale në mënyrë detaje të gjitha shpenzimet e parasë publike. Paraja është e qytetarëve dhe ata kanë të drejtë të dinë se si po e shpenzojmë këtë para, pra, të gjitha shpenzimet që i bëjmë si komunë duhet të ketë qasje edhe qytetari, domethënë në webfaqen komunale dhe me pasur qasje të drejtë dhe me ditur sa po shpenzohet, përndryshe është e nevojshme.

z.Bekim Azizi: Këtë draft strategji për informim që kemi, duke shpresuar që do të ketë ndikim edhe në rritjen e transparencës, kërkojmë që të aplikohet kjo strategji. Grupi i PDK-së e përkrah këtë strategji, vërejtjet i kemi dhënë edhe në KPF dhe besoj që ato vërejtje janë inkorporuar në këtë strategji.

z.Daut Xhemajli: Kërkoj falje, por në komitet e kemi përmendur diçka që nuk pat kohë për ta ndryshuar. Unë mendoj që pas këtij kuvendi duhet me ndryshuar atje ku mundet me u ndryshuar. Unë te faqja 15, ku kemi thënë ditë diaspore. Ne me vendim të komunës kemi Ditë të Mërgimtarëve - 1 Gushti, dhe kështu që duhet të rregullohet kjo punë, se po ta kishim ditë diaspore janë më shumë ditë dhe Ministria e Diasporës disi e ka të rregulluar këtë punë, por ne si Viti e kemi ditën e mërgimtarëve, ku mbahen gjitha aktivitetet. Tjetra, faqe 16, Ligji për Qasje në Dokumente Publike respektohet në përpikëri, kjo mendoj si fjali nuk duhet me qenë, sepse ne strategjinë e kemi bërë dhe bëjmë përpjekje me zbatuar ligjin, aq më shumë që mundemi, por me konstatuar nuk është mirë. Mendoj që nuk e ka vendin sofistikimi i zyrës për konferenca të shtypit, duhet me u paguar 3600 euro për 2015. Unë kam menduar që nuk kemi nevojë për ndonjë sofistikim të veçantë, mendoj që Zyrat e Kryetarit dhe zyret tjera ofrojnë kushte për paraqitjen për konferenca shtypi dhe mendoj që nuk është shpenzim që duhet bërë.

Diçka dua me përmendur, ndoshta mundet me shërbyer, kjo komunë disa herë kemi pasur informata që ka pasur buxhet ose ka paguar inventar për komunën e re, që s'po bëhet, unë mendoj që atë inventar komuna nuk e ka regjistruar dhe duhet me regjistruar, por megjithatë duhet me shfrytëzuar, nëse e kemi atë inventar nuk duhet me harxhuar mjete për inventar tjetër, nëse duhet edhe për këtë zyre duhet me u shfrytëzuar.

z.Hasan Aliu: Unë konsideroj që gjitha ato vërejtje që janë do të inkorporohen në këtë dokument. Dua të jap një sqarim, unë besoj që të gjitha pasqyrat financiare dalin në webfaqe, nëse keni ndonjë propozim tjetër urdhëroni.

Kryesuesi: E hedhim në votim: Kush është që të miratohet kjo strategji? Konstatohet se me vota unanime u miratuar edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Meqë drejtoresha e paska një takim në Prishtinë, kisha kërkuar nga ju delegatë që të më lejoni t'ia jap fjalën.

znj.Kaltrina Sylejmani: Me kërkesën e grave të Goshicës e keni parë që është duke u bërë një sensibilizim për integrimin e zonjave të komunës sonë nëpër shoqata, atëherë në mënyrë artistike Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, së bashku me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e kanë përkrahur shoqatën e grave "Goshica", që të bëj një ekspozim të veprave artizanale në galerinë e arteve. Kjo ekspozitë do të jetë si rezultat i punës dy mujore të zonjave të komunës sonë dhe poanta e daljes sime këtu është që të ndihmohet kjo shoqatë, duke marr pjesë atë ditë me 16 shkurt në ora 16 në galerinë e arteve. Kjo ekspozitë ka karakter shitës dhe mund të kontribuoni dhe motivoni ato që të inkuadrohen në jetën sociale.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi

4. Propozim vendim për hapjen e diskutimit publik për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm për Komunën e Vitisë

Ftoj Bushat Zuka, zyrtar në drejtori që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Bushat Zuka: Ky është një projekt i DEMOS-it, një projekt afatgjatë, që fillimisht po mendojmë 5 vjeçar me mundësi vazhdimi. Në vazhden e këtij projekti ne kemi dhënë disa prioritete që ju i keni para vetes, por duhet të merr vizën nga ju që të dal në shqyrtim publik. Materialin e keni para vetes, për vërejtje, sugjerime jemi të hapur.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë dikush ta merr fjalën?

z.Bislim Bislimaj: Në rend të parë në këtë mobilitet paraqet problem uzurpimi i hapësirave publike, sidomos rreth rrugëve, ndërtimeve e ndryshme e ne kot mendojmë për shtigjet e biçikletave, lëvizje të njerëzve. Në rrugën Drobesh-Viti ka pasur shumë aksidente, mirëpo ky trotuar edhe pse gjysmak ka ndikuar në uljen e aksidenteve. Problemi i hapësirës për çiklista është një problem, sepse në të ardhmen planifikimi i zgjerimeve për shkak të komunikacionit në rritje paraqet pengesë. Mendoj që rrugët duhet të zgjerohen. Te linjat urbanistike Prishtinë-Viti kam vërejtje, sepse përpara ka funksionuar edhe në mbrëmje, por tash kjo lidhje duhet të funksionalizohet, sepse u paraqet problem studentëve. Tjetra, për sigurinë në draft u flitke siguria në shkolla, duhet të përfshihet siguria edhe rrugës për në shkollë.

z.Bekim Azizi: Duke pasur parasysh që plani i mobilitetit paraqet sigurinë e komunikacionit, lëvizjen këmbësore, biçiklistave, duke pasur parasysh edhe një statistikë që është pas luftës, është shumë e rëndë, duke parë aksidentet me fatalitet, të cilat janë mbi 2000 vet, që është numër i madh, mendoj që në këtë plan disa gjëra janë paraqitur sipërfaqësisht, që duhet disa gjëra të bisedohen më seriozisht. Në Viti, besoj qytet duhet çdo rrugë veç e veç të jetë në planin e mobilitetit, p.sh.: udhëkryqi te rruga e Pozhoranit, këtu veç paraqitet që do një shqyrtim më të përgjegjshëm ose ndonjë studim të veçantë. Unë mendoj që është edhe te ura te shkollat e mesme atje, mendoj se edhe ajo duhet të jetë në planin e mobilitetit, sepse bëhet një ngërç i komunikacionit në intervale të caktuara. Ishujt e këmbësorëve janë përmendur në disa raste, ku zakonisht ishujt e këmbësorëve duhet të ketë hapësira më të gjëra, nuk e di sa është mundësia që kanë vetëm me nga një shirit komunikacioni në kahje të ndryshme, sepse ishujt paraqiten ku ka më shumë se dy shirita të komunikacionit. Pjesa te pasqyra, që është përmendur të bëhet hapësira për ndaljen e autobusëve, se aty bëhet zakonisht, aty duhet të studiohet mirë ai vend, sepse nuk e di sa do të ketë hapësirë edhe për qarkullimin të rrugës magjistrale edhe të jenë vendet që të jetë pjesa ku do të ndalen autobusat dhe pjesa e qarkullimit të këmbësorëve. Sinjalizimi horizontal zakonisht është përmendur dhe është diçka që duhet mirëmbahet, sepse sinjalizimi horizontal është nëpër vijat, këto heken për shkak të kualitetit, për shkak të kushteve, p.sh.: ngrica, këto krejt janë vetvetes që duhet të përsëriten shpesh, është e metë e tyre. Mirëpo, mendoj që duke i parë disa inxhiniera të komunikacionit që kanë kryer në fakultete të shtetit, nuk po i shoh përkund a nuk janë konsultuar a s'di çka është puna, mendoj që ka qenë mirë me diskutuar, është tjetër kur bisedohet për infrastrukturë që të rregullohet, është tjetër që të bisedohet për rregulla të komunikacionit. Infrastruktura zakonisht rregullohet prej njerëzve që marrin vesh në rrugë e jo njerëz që dinë me ec, me zhvillu komunikacionin. Ndërsa, ato që nuk respektohen, është pjesa që mund të kyçemi pak ma shumë, në diskutim besoj që do të marr vërejtje që janë adekuate dhe mendoj që duhet me u kompletuar, sepse është në interes të këtij vendi, është interes të qytetarëve dhe zhvillimit të komunikacionit.

z.Bushat Zuka: Është e vërtetë që ne kemi strukturë dhe kuadër të mjaftueshëm profesional, që duhet me konsultuar dhe kemi bashkëpunim shumë të ngushtë me ata që merren me çështje të komunikacionit, por në rastin konkret në kuadër të projektit DEMOS e kemi konsulent profesorin e fakultetit të inxhinierisë. Te udhëkryqi i Pozheranit i kemi dy mundësi, në bazë të planit rregullativ komunal është e paraparë që të bëhet një rrethrotullim por për momentin është e pamundur që të realizohet. Te siguria e nxënësve te shkolla i kemi bërë matjet dhe kemi konstatuar se mjafton shiriti i rrugës që fëmijët me pasur hapësirë. Te ura te shkolla, besoj që e dini që patën filluar punimet dhe do të vazhdojnë, se nëse na bllokohet ajo pjesë, atëherë na paralizohet i gjithë komunikacioni. Te pasqyra i kemi bërë matjet shumë të sakta dhe s'do të jetë stacion i autobusëve, por vendndalje dhe ka vend të mjaftueshëm për qarkullim. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal me regjistrimin e automjeteve

paguhet taksa dhe kështu mirëmbahen. Linja Prishtinë –Viti nuk është përgjegjësi dhe kompetencë e nivelit komunal.

Kryesuesi: Atëherë e hedhim në votim: Kush është që ky propozim vendim të shkoj për shqyrtim publik? Konstatohet se me vota unanime shkon kjo pikë e rendit të ditës për shqyrtim publik.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi

5. Raporti i punës së Këshillit komunal për siguri në bashkësi

Ftoj nënkryetarin e komunës të na njoftoj për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Hasan Aliu: Me udhëzim administrativ janë obligative në periudhën 6 mujore dhe 1 vjeçare, KSB-të duhet të bëjnë informime për aktivitetet të cilat i kanë zhvilluar. Po ju njoftoj se gjatë vitit 2015 ky këshill ka mbajtur 7 takime, me 6 takime të rregullta dhe 1 takim të jashtëzakonshëm, që është mbajtur për eksodin e madh që kishim dhe kemi një bashkëpunim të mirë me Policinë e Kosovës. Materialin e keni para jush, jam i hapur për pyetje, sqarime, vërejtje.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Samet Idrizi: Ka disa mangësi që e kanë përcjell këtë vit. Vendosi dhe funksionimi i kamerave nëpër shkollë dhe pjesët tjera të qytetit, shumë mirë që janë vendosur këto kamera, mirëpo, te shkollat “Bafti Haxhiu” duhet të vendosen dritat dhe të mos kenë mundësi personat privat të futen aty në derë të shkollës dhe të ketë mundësi vetëm personeli arsimor të futet aty, sidomos prej orës 8 që fillon mësimi aty mos të lejohen qytetar më shumë të rinj që të sillen nëpër oborr të shkollës si huligan, e kam qëllimin e mirë si propozim. Rritja e sigurisë trafik dhe qëndrimit të mërgimtarëve konkretisht. Vitin që shkoj unë shumë herë e kam parë që mërgimtarët vijnë me vetura të shtrenjta dhe gjithë ditën sillen rreth parkut dhe bëjnë zhurma të mëdha, që ta merr mendja që është duke u xhiruar ndonjë film aksion apo horror, kështu që është mirë policia të njoftohet që le të dalin më shumë në atë kohë dhe ta ndalojnë zhurmën. Unë kam qenë vet duke pirë kafe dhe njëri 2 orë ka bërë zhurmë vazhdimisht dhe mendoj që në këtë drejtim mund ky këshill të jap ndihmën e vet. Tjetra, vetëdijesimi i qytetarëve gjatë ahengeve familjare, kur ka dasma te na muzika vazhdon deri 3 natës dhe qytetarët mbesin pa gjumë. Rritja e sigurisë së qytetarëve në komunikacion përmes përdoruesve të shenjave të komunikacionit, unë e kam potencuar edhe më herët dëmtohen shenjat e komunikacionit sidomos ato vertikale dhe nuk drejtohen me kalimin 6 muaj – 1 vit, është mirë me identifikuar kush i dëmton dhe me e dënuar. Tjetër, rritja e sigurisë së këmbësorëve në vendbanimet e Komunës së Vitisë, po janë bërë disa trotuare shumë të mira, është mirë që janë bërë ato, ne jemi falënderuar, mirëpo, edhe shumë herë e kam potencuar trotuari para “Lindit” duhet ta bëjë komuna një kompromis me atë pronar dhe të zgjidhet ai problem që ka mbetur që 4-5 vite, ka mbetur shumë keq që qytetarët dhe nxënësit detyrohen me dal në rrugë, vie ndonjë veturë me shpejtësi dhe mundet me goditur ndonjë fëmijë. Edhe sensibilizimi i qytetarëve për përdorimin e mjeteve piroteknike, nuk e di se a kanë të drejtë qytetarët me shkuar dhe i vendosin ato bateritë e hedhjes së raketave në vend publik, në park dhe gjuajnë gjithë ditën, munden me lënduar dhe kanë lënduar qytetarë të pafajshëm dhe është mirë që të ndalohen gjërat e tilla në prona publike.

z.Hasan Aliu: Po më vjen mirë që shumicën që i keni cekur kam pasur takim edhe në Këshillin për Siguri në Bashkësi dhe e njëjta vërejtje është cekur për shkollën “Bafti Haxhiu”, se shkakton pasiguri për nxënësit dhe do shohim të veprojmë për të krijuar më shumë siguri për ta. Shqetësimet e juaja rreth atyre ngasësve të automjeteve do të koordinohemi me Policinë e Kosovës, që të ndërmerim masat e nevojshme.

Kryesuesi: Meqë kjo pikë nuk votohet, atëherë ju falënderojmë të gjithëve që dhatë kontribut për këtë pikë të rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi

6. Draft plani i punës për vitin 2016 i këshillit komunal për siguri në bashkësi

Ftoj Ibadete Hysenin që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Ibadete Hyseni: Këshilli për Siguri në Bashkësi kemi hartuar planin e punës për vitin 2016, i cili plan është harmonizuar edhe me planin nacional të veprimit. Në këtë plan janë përcaktuar objektivat, aktivitetet për realizimin e objektivave, bartësit e aktiviteteve, rezultatet e pritura, afati kohor dhe buxheti.

Pasi nuk kam diçka tjetër të shtoj, mirëpresim propozimet tuaja.

Kryesuesi: Hapim debat për këtë pikë të rendit të ditës, fjala është për ju.

Nëse nuk ka, atëherë e hedhim në votim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Me votat e gjithë të pranishme miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi

7. Propozim vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së seancave të Kuvendit Komunal të Vitisë

E hap debatin për këtë pikë të rendit të ditës: Nëse donë dikush ta merr fjalën?, atëherë: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatoj se me vota të gjithë të pranishme u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Me kaq e shpall të mbyllur këtë seancë, ju falënderoj për kontributin e dhënë.

Mirupafshim!

Mbledhja përfundo me punë në ora 14 e 30 min.

Procesmbajtës :
Ilir Zuka

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë
z. Naim Pira
